



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 345 Akti

Nr. 410 Vendimi
Tiranë, më 30.6.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli	Kryesuese
Roland Ilia	Relator
Etleda Çiftja	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Ertugena Sokoli, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, datë 28.6.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: Znj. **Atalanta Zeqiraj**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar”.

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Atalanta Zeqiraj, e cila në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve bazuar në paragrafin 5, të nenit 179/b, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit Atalanta Zeqiraj, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin më 12.11.2019, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit Atalanta Zeqiraj, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 1, i përbërë nga komisionerët Firdes Shuli, Roland Ilia dhe Etleda Çiftja.

4. Për këtë subjekt rivlerësimi u caktua me mirëkuptim kryesues i trupit gjykues komisionere Firdes Shuli, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Atalanta Zeqiraj.

5. Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit Atalanta Zeqiraj, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht, në nenin 30 të këtij ligji, kishte për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

7. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ). Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

8. Në përputhje me nenet 30-33 të ligjit nr. 84/2016 u administrua shkresa me nr. *** prot., datë 10.1.2018, e ILDKPKI-së, që ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit Atalanta Zeqiraj, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

9. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim

që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit, me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017 (deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. *** , datë 26.5.2021, të KDZH-së), në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë e vazhdimit të detyrës së subjektit të rivlerësimit Atalanta Zeqiraj.

10. Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për të dhënat e rezultuara nga tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti, pesë dokumentet ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, të dhënat arkivore të KLGJ-së, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. *** prot., datë 22.9.2020, për subjektin e rivlerësimit, ardhur në Komision me shkresën nr. *** prot., datë 20.10.2020.

11. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për të tria kriteret e vlerësimit: të pasurisë, të kontrollit të figurës, si dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

12. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë së figurës dhe vlerësimin profesional, në datën 11.5.2021 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Atalanta Zeqiraj; (ii) njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes; si dhe (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

13. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 14.6.2021 mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti u njoh me aktet e dosjes në datën 15.6.2021 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja më 23.6.2021.

14. Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me dosjen dhe ka marrë një kopje të saj, ka dërguar shpjegimet në rrugë zyrtare. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit në datën 23.6.2021, vendosi të ftojë znj. Atalanta Zeqiraj në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

15. Subjekti i rivlerësimit Atalanta Zeqiraj, u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail*, në datën 24.6.2021.

16. Seanca dëgjimore me subjektin u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 28.6.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

17. Subjekti i rivlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe për të parashtruar shpjegimet dhe opinionet e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit Atalanta Zeqiraj, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

18. Znj. Atalanta Zeqiraj ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë kërkuar. Subjekti ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

19. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

20. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

20.1 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

20.2 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

20.3 Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësisë profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

21. Referuar vendimit nr. 2/2017¹ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

¹“41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) deklaratat e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI;
- ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë referuar neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2016 dhe me shkresën nr. *** prot., datë 10.1.2018 ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Atalanta Zeqiraj, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me këtë subjekt të rivlerësimit ka konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Znj. Atalanta Zeqiraj është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2013, me numër indeksi *** dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave private:

- para fillimit të detyrës, vitit 2013;
- periodike/vjetore për vitet 2013 – 2017;
- deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, për efekt të ligjit nr. 84/2016.

Subjekti i rivlerësimit Atalanta Zeqiraj, për periudhën 21.10.2013 – 25.9.2015, ka kryer stazhin profesional si kandidate për gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga data 25.9.2015 e deri më sot, ushtron detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- ç) deklaratimet e subjektit me anë të komunikimit elektronik;
- d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit.

Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nisi shqyrtimin e deklaratimeve të interesave private dhe pasurore, të paraqitura më parë te ky institucion, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Atalanta Zeqiraj, pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, me nr. indeksi ***, datë 27.1.2017, për subjektin e rivlerësimit;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI për periudhën 2013 – 2016, në raport me të dhënat në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditetet – gjendje *cash*;
- ç) hetimit të kryer lidhur me të dhënat e vetëdeklaruara nga subjekti gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, të dorëzuar në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit Atalanta Zeqiraj ka deklaruar pasuritë si vijon:

1. Apartament i blerë nga babai P.Z me kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme me rezervë më 6.10.2015, në lagjen “****”, rruga “****”, kompleksi “****”, kulla C1, k. 8. Apartamenti është në pronësi të babait të subjektit dhe për përdorimin e tij nuk paguhet qira.

1.1 Për këtë pasuri, ILDKPKI-ja ka evidentuar se: *Është e paqartë mundësia financiare e shtetasit P.Z (babai i subjektit) për blerjen e apartamentit në Vlorë, në vlerën 3,800,000 lekë, në të cilën banon subjekti dhe familja e saj, pasi subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor lidhur me të ardhurat e këtij shtetasi.*

Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri

1.2 Pavarësisht se pasuria është blerë nga babai i subjektit të rivlerësimit para se ajo të fillonte të ushtronte detyrën, duke qenë se nga momenti i blerjes e në vijim pasuria është përdorur prej saj (referuar edhe dy dhuratave që babai i ka bërë subjektit në vitin 2014, përkatësisht në vlerat 200,000 lekë dhe 5,000 euro për blerjen e një automjeti), gjatë hetimit administrativ Komisioni e ka konsideruar babanë e subjektit si person tjetër të lidhur dhe ka kryer disa verifikime, me qëllim evidentimin e çdolloj lidhjeje të subjektit me këtë pasuri.

1.3 Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar se banon në apartamentin e blerë nga babai P.Z, me kontratën e shitjes së pasurisë me rezervë datë 6.10.2015. Vlera e blerjes së pasurisë është 3,800,000 lekë.

1.4 Rezultoi se në deklaratën *Vetting*, por edhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015 subjekti nuk ka deklaruar burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie të paluajtshme apartament që ka në përdorim.

1.5 ZVRPP-ja Vlorë, me shkresat nr. *** prot., datë 4.9.2017² dhe nr. *** prot., datë 8.6.2020³, nuk konfirmon pasuri të paluajtshme të regjistruar në emër të shtetasit P.Z në qytetin e Vlorës. Edhe FSHU-ja me shkresën nr. *** prot., datë 14.5.2020⁴, nuk konfirmon abonent në emër të shtetasit P.Z në qytetin e Vlorës.

1.6 ZVRPP-ja Vlorë ka konfirmuar se në emër të subjektit të rivlerësimit Atalanta Zeqiraj nuk figurojnë pasuri të paluajtshme të regjistruara në emër të saj.

1.7 Rezultoi se për këtë pasuri është lidhur kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme me rezervë nr. **, datë 6.10.2015, me palë shitëse E.J dhe A.K dhe palë blerëse shtetasin P.Z (babai i subjektit) dhe vlera e blerjes sipas kontratës është 3,800,000 lekë.

1.8 Kontrata përfundimtare e shitjes së kësaj pasurie të paluajtshme rezultoi se është lidhur më 22.10.2018, ku përcaktohen se palët janë likuiduar sipas kontratës së datës 6.10.2015.

1.9 Bazuar në konfirmimet e “Raiffeisen Bank”⁵ konfirmohet se babai i subjektit të rivlerësimit, z. P.Z , në datën 6.10.2015, ka transferuar në llogari të palës shitëse shumë prej 3,798,740 lekësh, për të likuiduar blerjen e këtij apartamenti.

1.10 QKB-ja ka konfirmuar se babai i subjektit P.Z është zotërues 100% i kuotave të kapitalit themeltar në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuara “Z” sh.p.k. (ortak i vetëm i shoqërisë) me status aktiv, regjistruar më 4.7.1996, me NIPT **, me aktivitetet “gërmime dheu, muratore dhe betonarme, prishje dhe punime toke”.

1.11 Subjekti është pyetur lidhur me burimin e ligjshëm për këtë pasuri në përdorim dhe, në përgjigje të pyetësorit⁶, ka deklaruar: *“Babai im, P.Z , është ortak i vetëm dhe administrator i shoqërisë ‘Z’ sh.p.k., regjistruar në datën 1.7.1996. Të ardhurat e tij gjenerojnë nga aktiviteti i shoqërisë. Pagesa, sipas kontratës, është kryer nga babai im, në datën 6.10.2015, nga llogaria e tij personale në ‘Raiffeisen Bank’. Burimi i të ardhurave në llogarinë personale të z. P.Z, janë marrje huaje nga shoqëria ‘Z’”.*

1.12 Subjekti, për të provuar deklaratimet e saj, lidhur me pagesat e kryera nga babai për blerjen e kësaj pasurie ka paraqitur njoftimin e debitimit ku pasqyrohet se shoqëria “Z” sh.p.k. me nr. llogarie ** ka dhënë hua për ortakun P.Z.

1.13 Sipas njoftim-debitimit datë 6.10.2015, është pasqyruar “dhënie huaje” nga shoqëria “Z” sh.p.k. te shtetasi P.Z, shuma prej 3,800,000 lekësh.

1.14 Sipas *statement*-it të llogarisë personale të babait P.Z , rezultoi transferta në hyrje e huas së marrë nga shoqëria “Z” sh.p.k., në datën 6.10.2015, si dhe në të njëjtën datë rezulton transferta në dalje për likuidimin e detyrimit kontraktor të blerjes së apartamentit.

1.15 Në përfundim Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës lidhur me:

- Subjekti dhe personi tjetër i lidhur (babai i subjektit) duhet të provojnë burimin e ligjshëm për krijimin e pasurive në përputhje me pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.
- Shpjegimet e dhëna dhe pasqyrat financiare të shoqërisë “Z” sh.p.k., të sjella si prova nga subjekti nuk sqarojnë në mënyrë shteruese kërkesën e Komisionit. Vlerat e dhëna në bilancet vjetore janë vlera në fund të vitit, të cilat nuk sqarojnë veprimet e bëra gjatë vitit.

²Shihni shkresën e ZVRPP-së Vlorë në dosjen e ILDKPKI-së.

³Shihni përgjigjen e ZVRPP-së Vlorë në dosjen e Komisionit.

⁴Shihni përgjigjen e FSHU-së në dosjen e Komisionit.

⁵Shihni dokumentet e “Raiffeisen Bank” në dosjen e ILDKPKI-së dhe Komisionit.

⁶Shihni përgjigjet e subjektit për pyetësorin nr. 2, në dosjen e Komisionit.

- Shpjegimet se pse subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie të paluajtshme në përdorim, në deklaratën *Vetting* dhe as në DPV-në për vitin 2015.

1.16 Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti deklaroi se:

“Kjo pasuri është blerë nga babai im P.Z, i cili nuk është person tjetër i lidhur sipas pikës 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016. Ai nuk ndodhet në kushtet e dhurimit apo huas.

Bazuar në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, përdorimi i pasurive të prindërve nga subjekti nuk përmbush kriteret e parashikuara nga ligji, për t’i konsideruar si persona të tjerë të lidhur. Kjo pasuri apartament nuk lidhet me detyrën time si gjyqtare dhe nuk ka të bëjë me ndonjë konflikt të mundshëm interesi. Kjo pasuri është blerë përpara se të filloja shqyrtimin e çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Vlorës. Burimi i krijimit të kësaj pasurie është huaja e marrë nga shoqëria ‘Z’, ku babai është aksioner i vetëm dhe administrator i shoqërisë. Sipas statementeve bankare rezulton se nga llogaria e shoqërisë ‘Z’ janë kaluar fondet për blerjen e pasurisë apartament në llogarinë e babait në datën 6.10.2015. Për kryerjen e veprimeve financiare të shoqërisë është hartuar edhe një raport nga audituesi ligjor z. A.M. Sipas audituesit veprimet financiare për dhënien e huas janë regjistruar dhe kontabilizuar në librat kontabël të shoqërisë”.

Vlerësimi i Komisionit

1.17 Subjekti i rivlerësimit ka në përdorim, pa kundërshtim, pasurinë apartament në Vlorë, e regjistruar në emër të babait të saj.

1.18 Është provuar gjatë hetimit se kjo pasuri është blerë me kontratën e shitjes së pasurisë me rezervë datë 6.10.2015, në vlerën 3,800,000 lekë. Bazuar në veprimet bankare⁷ rezultoi se në datën 6.10.2015 nga llogaria e shoqërisë “Z” sh.p.k. ka kaluar shuma prej 3,800,000 lekësh në llogarinë bankare të ortakut të shoqërisë, z. P.Z (babait të subjektit), me përshkrimin “dhënie huaje”.

1.19 Bazuar në deklaratën noteriale të datës 6.10.2015 (nr.***), lëshuar përpara noterit S. Sh nga babai i subjektit P.Z, konfirmohet kalimi i shumës 3,800,000 lekë në llogarinë bankare të noterit, në zbatim të kontratës së shitjes me rezervë të datës 6.10.2015.

1.20 Veprimet e kryera nga shoqëria te babai i subjektit dhe më pas të noteri për likuidimin e detyrimit kontraktor për blerjen e pasurisë apartament janë të rregullta dhe të provuara me anë të veprimeve përkatëse bankare.

1.21 Shuma prej 3,800,000 lekësh (burimi i krijimit të pasurisë në përdorim nga subjekti) u vërtetua të jetë marrë në formë huaje nga shoqëria “Z” sh.p.k. dhe më pas është bërë kalimi i kësaj shume te z. P.Z. Pra, huaja e marrë prej shoqërisë nga ortakut P.Z nuk rrjedh nga të ardhura nga dividendi.

1.22 Bazuar në raportin e audituesit të pavarur rezultoi se veprimi bankar për kalimin e vlerës prej 3,800,000 lekësh është kontabilizuar në librat kontabël të shoqërisë⁸, megjithëse kontabilizimi i paraqitur në ditarin e bankës së vitit 2015 nuk korrespondon me një veprim dhënie huaje ndaj ortakut. Si rezultat i kësaj, kjo hua, në vlerën 3,800,000 lekë nuk është pasqyruar në pasqyrat financiare të shoqërisë si veprim huadhënie e kryer në vitin 2015.

⁷Shihni veprimet në “Raiffeisen Bank” në praktikën e administruar nga Komisioni.

⁸Kontabilizimi është kryer në llogarinë *** “xhirime të brendshme” dhe në fund të vitit në llogarinë *** “arka”.

1.23 Xhiroja e shoqërisë “Z” sh.p.k. për vitin 2015, bazuar te pasqyrat financiare, rezultoi në shumën 71,633,639 lekë. Bazuar në *statement*-in bankar⁹ gjendja e llogarisë në “Raiffeisen Bank” e shoqërisë “Z” sh.p.k. para huadhënies ishte në shumën 10,138,175 lekë.

1.24 Lidhur me pretendimin e subjektit se babai i saj nuk është person tjetër i lidhur në kuptim të ligjit nr. 84/2016, Komisioni e vlerësoi në tërësi këtë pretendim në raport me dispozitat ligjore në fuqi.

1.25 Pika 11 e nenit 3 përkufizon termin “pasuri”: “... që janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme ... që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit”. Pra, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe ka pranuar gjatë hetimit që pasurinë apartament në pronësi të babait e ka në përdorim pa kundërshtim dhe, për këtë, ka detyrimin të deklarojë dhe provojë burimin e ligjshëm të krijimit për të shmangur çdo dyshim të mundshëm. Në këto rrethana, mosdeklarimi i burimit të krijimit të pasurisë në përdorim është një pasaktësi në deklaram.

1.26 Bazuar në pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës ku parashikohet se: “... pasuri të ligjshme për qëllime të ligjit konsiderohen të ardhurat e deklaruara për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Për qëllime të procesit të rivlerësimit si të ardhura të ligjshme duhen konsideruar vetëm të ardhurat, të cilat plotësojnë në mënyrë kumulative dy kritere: (i) janë të deklaruara; dhe (ii) për të cilat vërtetohet pagimi i detyrimeve tatimore sipas legjislacionit në fuqi”.

1.27 Gjatë hetimit Komisioni nuk konstatoi ndonjë konflikt të mundshëm interesi të subjektit të rivlerësimit për këtë çështje që lidhet me pasurinë apartament në përdorim.

Arsyetim ligjor bazuar në ligjin e zbatueshëm

1.28 Sa i takon pretendimit të subjektit se shtetasi P.Z nuk është person tjetër i lidhur, sipas pikës 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016 dhe se nuk ndodhet në kushtet e huas apo dhurimit duke iu referuar jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit, sipas së cilës përdorimi i pasurive të prindërve nga subjekti nuk përmbush kriteret e parashikuara nga ligji, për t’i konsideruar ata si persona të tjerë të lidhur, Komisioni arsyeton se:

Pika 14 e nenit 3 përkufizon personat e tjerë të lidhur si vijon: “*Persona të tjerë të lidhur janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi*”. Ndërsa pika 4 e nenit 32 parashikon se: “*Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruara në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive*”.

Siç vërehet, qenia ose jo e një personi në cilësinë e personit tjetër të lidhur është kushtëzuar nga një marrëdhënie interesi me subjektin e rivlerësimit, e cila mund të burojë edhe nga një marrëdhënie huadhënieje. Në rastin konkret, edhe pse babai i subjektit të rivlerësimit nuk është cilësuar specifikisht si një huadhënës, *de facto* i ka dhënë në huapërdorje vajzës së tij pasurinë objekt shqyrtimi, e cila përdoret vetëm prej saj që prej momentit të blerjes në vitin 2015 e deri sot. Marrëdhënia midis tyre, përtej faktit që është një marrëdhënie shumë e ngushtë familjare prind-fëmijë, në thelb është një marrëdhënie interesi pasuror derisa subjekti përdor pa kundërshtim një pasuri që nuk është në pronësi të saj. Është e vërtetë që në disa raste të trajtuara nga Kolegji, përdorimi i pasurive të prindërve nuk është konsideruar si kriter i

⁹Shihni shkresën e “Raiffeisen Bank” në dosjen e Komisionit.

parashikuar nga ligji për t'i konsideruar ato si persona të tjerë të lidhur. Por, përveç faktit që secila prej çështjeve ka specifikat dhe rrethana konkrete të ndryshme nga njëra-tjetra, Kolegji orienton Komisionin që të kryhen veprime hetimore për pasuritë në përdorim të subjekteve të rivlerësimit, me qëllim heqjen e çdo dyshimi për një pronësi të mundshme të fshehur në emër të tyre apo blerjen e pasurive në përdorim me të ardhura të tyre. Ky ka qenë edhe qëllimi i ligjit, i cili ka përcaktuar si detyrim ligjor të subjekteve deklarimin në deklaratën *Vetting* të çdo pasurie në pronësi dhe në përdorim, si dhe burimeve të ligjshme për krijimin e tyre.

Bazuar në të gjitha sa është arsyetuar më sipër, nga Komisioni u kryen hetime shteruese në përfundim të të cilave nuk rezultuan lidhje të subjektit të rivlerësimit me pasurinë objekt shqyrtimi, referuar fakteve si vijojnë:

- i) Nuk u vërtetua asnjë transaksion bankar apo kryerja e ndonjë veprimi me akt shkresor ose jo me palë pjesëmarrëse subjektin apo bashkëjetuesin e saj, që të ketë pasur për objekt pasurinë objekt shqyrtimi.
- ii) FSHU-ja, UKT-ja dhe asnjë institucion tjetër nuk kanë konfirmuar kontrata të lidhura nga subjekti apo bashkëjetuesi i saj për këtë pasuri.
- iii) Nuk u evidentua ndonjë konflikt interesi gjatë ushtrimit të detyrës nga subjekti me shitësin e pasurisë.
- iv) Nuk u evidentua dhe nuk ka pasur asnjë të dhënë nga cilido burim i ligjshëm për çfarëdo lloj lidhje të subjektit me pasurinë objekt shqyrtimi.
- v) Subjekti i rivlerësimit, me Dekretin nr. 9239 datë 25.9.2015, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, është emëruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Deri në momentin e emërimit ka ushtruar stazhin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 7.10.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, rezultoi se duke filluar nga data 7.10.2015, gjyqtarja Atalanta Zeqiraj ka gjykuar vetëm çështje civile të veçanta.

Pra, periudha e blerjes së pasurisë nga babai i subjektit përkon me periudhën e fillimit të ushtrimit të detyrës si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, fakt që përjashton në mënyrë absolute mundësinë e sigurimit prej saj të të ardhurave të paligjshme për shkak të ushtrimit të detyrës si gjyqtare.

Sa i takon burimit të ligjshëm të të ardhurave për blerjen e pasurisë nga babai i subjektit, ndonëse nuk u vërtetua kontabilizimi i saktë (nga ekonomisti i shoqërisë) i dhënies së huas të shoqërisë "Z" sh.p.k., ndaj ortakut të vetëm P.Z në shumën 3,800,000 lekë, në konsideratë të rrethanave si vijojnë:

- i) shoqëria "Z" sh.p.k. ka pasur shuma të konsiderueshme të qarkullimit vjetor dhe mjete monetare të lira dhe ka paguar rregullisht detyrimet tatimore;
- ii) administratori i kësaj shoqërie, z. P.Z, nuk ka qenë asnjëherë subjekt deklarues;
- iii) fakti që pagesa e çmimit të shitjes prej z. P.Z e ka filluesën në një llogari bankare të shoqërisë, të çelur kohë më parë se të bëhej pagesa;
- iv) faktit që të gjitha transfertat janë kryer në rrugë bankare në të njëjtën ditë, në përfundim të procesit të rivlerësimit.

Komisioni nuk mundi të arrijë në konkluzionin që ky shtetas nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e pasurisë.

Sa i takon mosdeklarimit të burimit të ligjshëm për krijimin e pasurisë, Komisioni çmoi se deklarimi i subjektit është i pasaktë, pasi mungon të jetë përmbushur detyrimi ligjor nga subjekti. Por, për sa kohë nuk u vërtetua që pasuria të jetë blerë me të ardhura të paligjshme të subjektit të rivlerësimit, për të cilin nuk u vërtetuan lidhje me pronesinë kësaj pasurie, përveç

faktit që e përdor pasurinë e blerë nga babai, një praktikë e njohur në Shqipëri, buruar prej marrëdhënieve prind-fëmijë, pasaktësia në deklaramin mbetet e tipit formal dhe nuk përbën shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

1.29 Në përfundim, sa i takon pasurisë objekt shqyrtimi, duke arsyetuar mbi bazën e parimeve të objektivitetit të proporcionalitetit, në konsideratë të fakteve e provave të administruara, si periudhën e përdorimit të pasurisë nga subjekti; fillimin e detyrës së saj si gjyqtare; burimin e krijimit të pasurisë, vlerat dhe mundësitë financiare të shoqërisë “Z” sh.p.k, faktin që çdo veprim është kryer nga babai i subjektit si përfaqësues ligjor i shoqërisë dhe jo nga subjekti, mungesën e çdo lloj lidhjeje e indicjeje për lidhje të subjektit me pronësinë e kësaj pasurie, në raport edhe me shpjegimet e subjektit, Komisioni çmon që subjekti nuk ndodhet në asnjë prej situatave të parashikuara në pikat 1 dhe 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

2. Llogari bankare në “Tirana Bank”

2.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar llogari bankare në “Tirana Bank”, me gjendje në datën 27.1.2017 (data e deklaraminit) shumën prej 8,276 lekësh.

2.2 Burimi i krijimit është deklaruar nga të ardhurat nga paga si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Vlera e llogarisë është 8,276 lekë.

2.3 Bazuar në konfirmimin e “Tirana Bank”¹⁰, rezultoi se në emër të shtetases Atalanta Zeqiraj, për periudhën 2015 – 2017, gjendja e llogarisë në datën 27.1.2017 është në vlerën 8,276 lekë.

2.4 Rezultoi se kjo është llogari bankare e subjektit, ku janë kryer veprimet për kalimin e pagës nga marrëdhëniet e punës dhe tërheqjet e herëpashershme të subjektit për shpenzimet e kryera.

2.5 Komisioni konstatoi se subjekti ka deklaruar saktë këtë llogari bankare, nuk janë konstatuar problematika dhe në analizën financiare janë pasqyruar të gjitha veprimet e kryera nga subjekti në këtë llogari.

Deklarimi i pasurisë për personin e lidhur/bashkëjetuesi Sh.Xh

3. Llogari bankare në BKT

3.1 Subjekti ka deklaruar llogari bankare në BKT, në emër të bashkëjetuesit Sh.Xh, me gjendje më 27.1.2017 (data e deklaraminit), në vlerën 36,350 lekësh.

3.2 Si burim krijimi janë deklaruar të ardhura nga kursimi i pagës për vitin 2016 si programues kompjuteri pranë shoqërisë “T” sh.p.k.

3.3 Bazuar në konfirmimin e BKT-së¹¹ rezultoi se shtetasi Sh.Xh ka gjendje në datën 23.1.2017, në këtë llogari bankaren vlerën prej 36,350 lekësh.

3.4 BKT-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 1.8.2017 (ndodhur në dosjen e ILDKPKI-së) konfirmon se shtetasi Sh.Xh disponon llogari page me gjendje në datën 27.1.2017, në vlerën 36,350 lekë.

3.5 Rezultoi se kjo është llogari bankare e bashkëjetuesit të subjektit ku janë kryer veprimet për kalimin e pagesave nga shoqëria “T” sh.p.k.

3.6 Komisioni konstatoi se subjekti ka deklaruar saktë këtë llogari bankare, nuk janë konstatuar problematika me këtë llogari dhe në analizën financiare janë pasqyruar të gjitha veprimet e kryera nga bashkëjetuesi i subjektit në këtë llogari.

¹⁰Shihni përgjigjen e “Tirana Bank” në dosjen e ILDKPKI-së dhe të Komisionit.

¹¹Shihni përgjigjen e “Tirana Bank” në dosjen e ILDKPKI-së dhe të Komisionit.

4. Automjet tip “Mercedes-Benz”

4.1 Subjekti dhe bashkëjetuesi kanë deklaruar automjetin tip “Mercedes-Benz B Class”, me targa AA *** KS, blerë në vlerën 5,000 euro.

4.2 Rezultoi se me anë të kontratës për shitje automjeti nr. ***, datë 9.12.2014, bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit Sh.Xh ka blerë automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targa AA *** KS. Sipas kontratës, vlera e blerjes së kësaj pasurie është në vlerën 5,000 euro.

4.3 Për këtë pasuri rezultoi edhe një deklaratë noteriale nr. ***, datë 27.3.2015, ku shtetasi P.Z (babai i subjektit) deklaroi se i ka dhënë bashkëjetuesit të vajzës Sh.Xh shumën 5,000 euro, në formë ndihme, të cilën ai e ka përdorur për të blerë automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targa AA *** KS. Kjo deklaratë noteriale është lëshuar disa muaj pas blerjes së automjetit.

4.4 DPSHTRR-ja ka konfirmuar se shtetasi Sh.Xh ka të regjistruar në pronësinë e tij automjetin me targa AA *** KS, përfituar me kontratë shitje automjeti nr. ***, datë 9.12.2014, në vlerën 5,000 euro.

4.5 Gjatë procesit të rivlerësimit, u konstatua se:

- i) Regjistrimi i automjetit është kryer rreth një vit pasi është blerë nga bashkëjetuesi i subjektit.
- ii) Dhurimi i këtij automjeti nuk është deklaruar nga subjekti në DPV-në për vitin 2014, ndërkohë që është deklaruar pronësia mbi automjetin, blerë sipas kontratës së shitjes datë 9.12.2014.
- iii) Duket se automjeti është përdorur nga shitësi A.J edhe pas shitjes së tij, pasi rezultoi të ketë nënshkruar siguracionin e detyrueshëm pas vitit 2014. Për të sqaruar në lidhje me këto konstatime, si dhe marrëdhënien me shtetasin A.J, është pyetur subjekti i rivlerësimit.

4.6 Subjekti i rivlerësimit¹² është pyetur lidhur me këtë pasuri dhe për burimin e krijimit.

4.7 Në përgjigje të pyetësorit¹³ subjekti deklaroi:

“Bashkëjetuesi im Sh.Xh ka deklaruar pronësinë e automjetit në cilësinë e blerësit të automjetit sipas kontratës së shitjes datë 9.12.2014, në DPV-në e vitit 2014 dhe burimi i të ardhurave janë dhurim nga babai im.

Lidhur me mundësitë financiare të babait, ai është ortak i vetëm dhe administrator i shoqërisë ‘Z’ sh.p.k. Babai ka pasur mjete monetare të lira në llogaritë likuiduese të shoqërisë ‘Z’ sh.p.k., për të cilat ka tërhequr në formën e huas shumën që nevojitej për blerjen e automjetit.

Bashkëjetuesi im nga momenti i lidhjes së kontratës së shitjes datë 9.12.2014, e ka konsideruar të kryer procedurën e kalimit të pronësisë dhe nuk ka pasur informacion se duhej bërë një procedurë tjetër për ndryshimin e emrit të lejes së qarkullimit. Në kontratën e shitblerjes citohet: ‘Me firmosjen e kësaj kontrate shitësi zhvishet nga pronësia mbi këtë automjet dhe pronari i saj bëhet blerësi’. Në të njëjtën kohë është marrë konfirmim pranë RBS-së, nëpërmjet noteres ku janë kryer veprimet (sikurse përcaktohet në kontratë).

Veprimet lidhur me regjistrimin janë kryer vetëm prej bashkëjetuesit tim Sh.Xh në cilësinë e palës blerëse dhe pronarit të automjetit. Veprimet për regjistrimin janë kryer pas një viti, pasi bashkëjetuesi nuk ka pasur dijeni.

Siguracioni i prerë më 12.12.2015 dhe ai i dhjetorit 2016 janë paguar dhe firmosur (emër, mbiemër, nënshkrim me dorë) vetëm nga bashkëjetuesi Sh.Xh. Pala shitëse, A.J, nga momenti i nënshkrimit të kontratës së shitblerjes nuk e ka përdorur më automjetin objekt kontrate, si

¹²Shihni pyetësorin nr. 2 dërguar nga Komisioni subjektit të rivlerësimit.

¹³Shihni përgjigjen e pyetësorit nr. 2 nga subjekti i rivlerësimit.

dhe nuk ka kryer asnjë veprim tjetër për këtë automjet. Gjithashtu, më 12.12.2016, bashkëjetuesi im ka paguar tarifën për ndërrimin e pronësisë së mjetit.

Pala shitëse, A.J nga momenti i nënshkrimit të kontratës së shitblerjes nuk e ka përdorur më automjetin objekt kontrate si dhe nuk ka kryer asnjë veprim tjetër për këtë automjet.

Me shtetasin A.J nuk kam pasur dhe nuk kam asnjë marrëdhënie. E vetmja marrëdhënie e tij me shtetasin A.J është ajo e realizimit të kontratës së shitblerjes për automjetin. Nuk kanë pasur njohje të mëparshme dhe as aktualisht nuk ka asnjë marrëdhënie”.

4.8 Rezultoi se certifikata e kontrollit fizik për këtë automjet është lëshuar më 12.12.2016, në emër të bashkëjetuesit të subjektit.

4.9 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti deklaroi se siguracioni i vitit 2016, për automjetin në pronësi të bashkëjetuesit Sh.Xh, nuk është firmosur nga shtetasi A.J. Komisioni i kërkoi subjektit të deklarojë se firma e kujt është hedhur në këtë siguracion mbi emrin e shtetasit A.J.

4.10 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit¹⁴, deklaroi se: *“Nga komunikimi me bashkëjetuesin tim, më deklaroi se nuk kujton ekzaktësisht se si ka ndodhur nëse është vendosur shënimi nga ai apo agjenti, pasi firmosja e policës së sigurimit nuk është e detyrueshme në praktikën e agjencive të sigurimit. Ndërkaq, provohet se pagesa është kryer prej bashkëjetuesit tim Sh.Xh pranë ‘A’ sh.a., dega Vlorë”.*

4.11 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, drejtuar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim për dhurimin e vlerës 5,000 euro për blerjen e automjetit nga shtetasi Sh.Xh, tërheqje nga z. P.Z në formë huaje nga llogaria e shoqërisë “Z” sh.p.k.

4.12 Pas kësaj përgjigjeje, subjekti u pyet që të vërtetojë mundësinë financiare të babait për dhurimin e kësaj shume dhe në qoftë se këto para janë marrë hua nga shoqëria “Z” sh.p.k., të vërtetonte me dokument pasqyrimin e kësaj huaje në pasqyrat financiare të shoqërisë apo shpërndarjen e dividendit nga shoqëria.

4.13 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, deklaroi se:

“Sikurse kam shpjeguar te pyetësori nr. 2, burim i të ardhurave të babait tim janë të ardhurat që gjeneron shoqëria. Babai më referon se në datën 21.10.2014 ka tërhequr shumën prej 6,000 euro nga shoqëria ‘Z’ sh.p.k. dhe e cila më pas ka shërbyer për të blerë automjetin, i cili është në pronësi të bashkëjetuesit tim. Rezulton se shoqëria ‘Z’ sh.p.k. ka pasur mjete monetare të lira të disponueshme, të cilat burojnë nga aktiviteti i saj dhe ato janë tërhequr prej ortakut të vetëm sipas nevojave konkrete. Për të provuar këtë fakt po paraqes nxjerrje llogarie për shoqërinë ‘Z’ sh.p.k. për periudhën 1.10.2014 - 31.12.2014 nga ‘Raiffeisen Bank’ sh.a. (datë printimi 16.1.2015).

*Lidhur me pasqyrimin e huas në pasqyrat financiare të shoqërisë në vitin 2014, ekonomisti më sqaron se, shuma prej 6.000 euro, e tërhequr nga llogari likuiduese e shoqërisë ‘Z’ sh.p.k. me nr. ***, pranë ‘Raiffesen Bank’ është e regjistruar në kontabilitetin e shoqërisë në dokumentin kontabël ‘Ditar i Bankës’ me veprimin kontabël tërheqje nga llogaria ortaku P.Z për shumën 835,260 lekë (6.000 euro *139,21 lek/euro). Veprimet kontabël në pasqyrat financiare janë të paraqitur në llogarinë *** ‘Të drejtat dhe detyrimet ndaj ortakëve’, siç e kam shpjeguar të detajuar në përgjigjen e mësipërme të pyetjes nr. 1. Po kështu, në funksion të të provuarit të ligjshmërisë së të ardhurave po paraqes vërtetim se nga ana e shoqërisë janë paguar detyrimet tatimore”.*

¹⁴Shihni përgjigjen e pyetësorit nr. 3 nga subjekti i rivlerësimit.

4.14 Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka paraqitur edhe disa shpjegime¹⁵ lidhur me kërkesën e bërë nga Komisioni për vërtetimin e pasqyrimit në pasqyrat financiare të veprimit të dhurimit në vlerën prej 5,000 euro vlerën e automjetit të blerë në emër të bashkëjetuesit të subjektit, por të financuar nga babai i saj.

4.15 Në përfundim, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, lidhur me:

- Në DPV-në e vitit 2014 nuk është pasqyruar vlera prej 5,000 euro në rubrikën “Dhurata dhe trajtime preferenciale”, por e përshkruar vetëm si burim i të ardhurave për blerjen e automjetit, (dhurim nga babai i subjektit).

- Duket se veprimet për regjistrimin e automjetit janë kryer nga bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit shumë kohë pas lidhjes së kontratës së shitblerjes së këtij automjeti.

- Shpjegimet e dhëna dhe pasqyrat financiare të shoqërisë “Z”, të sjella si prova nga subjekti nuk sqarojnë në mënyrë shteruese kërkesën e Komisionit dhe burimin e ligjshëm të huas për blerjen e kësaj pasurie në vlerën 5,000 euro. Vlerat e dhëna në bilancet vjetore janë vlera në fund të vitit, të cilat nuk sqarojnë veprimet e bëra gjatë vitit. Subjekti duhej të kishte sjellë të dhëna/regjistrime më analitike për të vërtetuar veprimet e kryera nga shoqëria lidhur me pasqyrimin e veprimeve në fjalë.

- Mbetet i pavërtetuar burimi i ligjshëm i dhurimit të vlerës prej 5,000 euro nga babai i subjektit, P.Z. Duket se personi tjetër i lidhur, babai i subjektit, nuk ka pasur mundësi për krijimin e shumës së dhuruar prej 5,000 euro.

4.16 Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti deklaroi se:

“Në DPV-në e vitit 2014 është deklaruar pasuria automjet dhe burimi i krijimit që është dhurimi nga babai im i shumës prej 5,000 euro.

Bashkëjetuesi, nga momenti i lidhjes së kontratës së shitjes e ka konsideruar të mbyllur procedurën e kalimit të pronësisë dhe nuk ka pasur informacion se duhej bërë një procedurë tjetër për ndryshimin e emrit të lejes së qarkullimit.

Në lidhje me burimin e vlerës prej 5,000 euro po paraqes gjetjet e audituesit A.M lidhur me veprimet e kryera nga babai dhe shoqëria ‘Z’ si huadhënëse.

Shuma prej 5,000 euro është tërhequr nga llogaria e shoqërisë ‘Z’ dhe është regjistruar në dokumentin kontabël ‘ditari i bankës’.

Sipas audituesit veprimet financiare për dhënien e huas janë regjistruar dhe kontabilizuar në librat kontabël të shoqërisë për vitin 2014”.

Vlerësimi i Komisionit

4.17 Pavarësisht se subjekti nuk ka deklaruar dhurimin e shumës 5,000 euro në rubrikën “dhurata dhe trajtime preferenciale” ka deklaruar dhurimin nga babai i saj prej 5,000 euro si burim për blerjen e pasurisë automjet në vitin 2014 nga bashkëjetuesi. Dhurimi i kësaj shume është vërtetuar edhe me deklaratë noteriale të datës 27.3.2015, lëshuar nga babai i subjektit. Pra, ka një pasaktësi në deklaram, por jo fshehje nga subjekti i rivlerësimit të shumës së dhuruar. Për rrjedhojë, pasaktësia në deklaram është e tipit formal dhe pa pasoja.

¹⁵Shihni përgjigjen e detajuar të subjektit lidhur me pyetësorin nr. 3.

4.18 Është provuar gjatë hetimit se kjo pasuri automjet është blerë me kontratën e shitjes në datën 9.12.2014, në vlerën 5,000 euro. Bazuar në veprimet bankare¹⁶ rezultoi se në datën 21.10.2014, nga llogaria e shoqërisë “Z” sh.p.k., është tërhequr shuma prej 6,000 euro nga ortaku i vetëm P.Z (babait të subjektit).

4.19 Komisioni konstatoi se shuma prej 6,000 euro (burimi i krijimit të pasurisë automjet) është marrë në formë huaje nga shoqëria “Z” sh.p.k., por kjo shoqëri nuk rezultoi të ketë kryer veprime për shpërndarje fitimi në vitin 2014, periudhë e cila përkon me dhurimin e kryer. Pra, rezultoi se është dhënë hua nga shoqëria “Z” sh.p.k., tek ortaku i vetëm P.Z dhe jo si shpërndarje fitimi të shoqërisë.

4.20 Bazuar në raportin e audituesit të pavarur rezultoi se veprimi bankar për kalimin e vlerës prej 6,000 euro është kontabilizuar në librat kontabël të shoqërisë dhe kontabilizimi i paraqitur në ditarin e bankës të vitit 2014, korrespondon me një veprim dhënie huaje ndaj ortakut. Si rezultat i kësaj, kjo hua në vlerën 6,000 euro duhet të jetë pasqyruar në pasqyrat financiare të shoqërisë si veprim i kryer në vitin 2014.

4.21 Xhiroja e shoqërisë “Z” sh.p.k., për vitin 2014, bazuar te pasqyrat financiare rezultoi në shumën 62,857,603 lekë. Bazuar në *statement*-in bankar¹⁷, gjendja e llogarisë në “Raiffeisen Bank”, e shoqërisë “Z” sh.p.k., para huadhënies, ishte në shumën 27,816 euro. Nisur nga këto fakte (xhiroja dhe mjetet monetare të lira), Komisioni krijoi bindjen për mundësitë financiare të mjaftueshme të shoqërisë për të përballuar huan e dhënë ndaj ortakut të vetëm.

4.22 Komisioni, pas shpjegimeve të dhëna nga subjekti, pas rezultateve të hetimit dhe pas analizimit të provave të administruara të paraqitura nga subjekti, doli në konkluzionin se: *Kontabilizimi nga shoqëria “Z” sh.p.k. e veprimit të dhënies hua ndaj ortakut P.Z, përbën një pasqyrim të saktë të realitetit dhe situatës financiare. Për pasojë, ky veprim nuk ka sjellë dhe nuk mund të sjellë në të ardhmen shmangie të detyrimeve tatimore.*

4.23 Bazuar në pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, ku parashikohet se: *“... pasuri të ligjshme për qëllime të ligjit konsiderohen të ardhurat e deklaruara, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Për qëllime të procesit të rivlerësimit si të ardhura të ligjshme duhen konsideruar vetëm të ardhurat, të cilat plotësojnë në mënyrë kumulative dy kritere: (i) janë të deklaruara; dhe (ii) për të cilat vërtetohet pagimi i detyrimeve tatimore sipas legjislacionit në fuqi”*.

4.24 Marrja e huas nga shoqëria “Z” sh.p.k. për dhurimin në shumën 5,000 euro dhe reflektimi i kësaj huaje në librat e shoqërisë dhe pastaj në pasqyrat financiare nuk ka sjellë shmangie të detyrimeve tatimore, pavarësisht së veprimi i përfitimit të shumës prej 6,000 euro nuk është bërë duke shpërndarë fitimin (dividendin) në fund të vitit përkatës. Komisioni konstaton se ky veprim është përfshirë në dokumentet kontabël të shoqërisë si hua e dhënë që do të thotë se është kontabilizuar si vlerë brenda bilancit të shoqërisë për të cilën në të ardhmen do të paguhen detyrimet përkatëse në buxhetin e shtetit (në kohën kur do të shpërndahet fitimi i shoqërisë).

4.25 Në përfundim, duke marrë në konsideratë deklaratimet e subjektit, shumën e përfituar si dhurim, burimin e dhurimit, veprimet e kryera dhe të reflektuara nga shoqëria “Z” sh.p.k. në librat përkatës, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me dhurimin e shumës prej 5,000 euro (e cila ka shërbyer për blerjen e pasurisë automjet), pasi u provua burimi i ligjshëm i krijimit.

¹⁶Shihni veprimet në “Raiffeisen Bank” në praktikën e administruar nga Komisioni.

¹⁷Shihni shkresën e “Raiffeisen Bank” në dosjen e Komisionit.

Veç kësaj, Komisioni ka mbajtur në konsideratë faktin se bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 31.5.2021, subjekti i rivlerësimit Atalanta Zeqiraj ka kryer stazhin profesional si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për periudhën 21.10.2013 – 25.9.2015. Pra, periudha e dhurimit të shumës prej 5,000 euro nga babai i saj përkon me periudhën e fillimit të ushtrimit të stazhit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe jo me periudhën kur ajo ka ushtruar detyrën e gjyqtares.

Konstatime të tjera

5. Apartamenti në përdorim në vitin 2014, në Tiranë

5.1 Në përgjigje të pyetësorëve, subjekti ka deklaruar se ka përdorur pa kundërshtim në periudhën shtator 2014 - tetor 2015, pasurinë apartament nr. ***, rruga “***”, h. ***, ap. ***, Tiranë, në pronësi të babait të saj.

5.2 Gjatë hetimit rezultoi se kjo pasuri është blerë nga babai i subjektit të rivlerësimit me kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. ***, datë 12.9.2014, në vlerën 50,000 euro. Palë shitëse e pasurisë rezultoi shtetasja L.N.

5.3 Pasuria është e llojit apartament me sip. 45 m², nr*** /Nd ***, z. k. ***, h. ***, ap. ***, në rrugën “ *** ”, Tiranë.

5.4 Edhe pse pasuria është blerë para se subjekti të ushtronte detyrën e gjyqtares, subjekti i rivlerësimit u pyet për të provuar mundësitë financiare të babait për blerjen e kësaj pasurie.

5.5 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti deklaroi:

*“Lidhur me mundësitë financiare të babait tim, P.Z, për blerjen e apartamentit të ndodhur në qytetin e Tiranës, rruga ‘***’, po shpjegoj si më poshtë: Pagesa prej 50,000 euro është kryer nëpërmjet derdhjes nga babai im P.Z në llogarinë e noterit L.D me përshkrimin ‘P.Z derdh për blerjen e apartamentin nr. ***/ND ***, z. k. ***, vol. ***, f. ****, *** 45 m²’ (depozitim për të tretë pranë ‘Raiffeisen Bank’, datë 12.9.2014). Më pas, më 4.11.2014, shuma prej 50,000 euro ka kaluar nga llogaria e noterit tek pala shitëse L.N me nr. llogarie ***, ku në pjesën detajet e pagesës është shënuar ‘kalim fondi sipas kontratës nr. ***, nr. pasurie ***/ND+ ***, z. k. *** (njoftim debitimi datë 4.11.2014).*

*Pagesa është kryer nga shuma e tërhequr nga llogaria në euro me nr. *** e shoqërisë ‘Z’ sh.p.k. më 9.1.2014. Për të provuar mundësinë financiare të babait tim për të kryer pagesën e apartamentit, po paraqes faqen e statement të llogarisë në euro me nr. *** të shoqërisë ‘Z’ sh.p.k.*

Bashkëlidhur do të gjeni edhe kopjen e kontratës së shitjes, depozitim për të tretë dhe njoftim debitimi të cilat janë paraqitur në origjinal me dorëzimin e pyetësorit standard”.

5.6 Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit që të vërtetonte burimin e ligjshëm të kësaj shume dhe të dokumentonte pasqyrimin e këtij veprimi në pasqyrat financiare të shoqërisë, ku babai i saj rezulton ortak i vetëm dhe administrator i saj.

5.7 Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, ka shpjeguar se:

*“Shuma 50.000 euro është tërhequr nga llogari likuiduese e shoqërisë ‘Z’ sh.p.k. me nr. ***, në ‘Raiffeisen Bank’ dhe është e regjistruar në kontabilitetin e shoqërisë në dokumentin kontabël ‘Ditar i Bankës’ me veprimin kontabël: ‘debitohet llogaria *** ‘Të drejta dhe detyrime të ortaku marrë hua në shoqëri’ me përshkrimin, huadhënie tërheqje nga llogaria ortaku P.Z dhe kreditohet llogaria *** ‘Banka llogari likuiduese’ për shumën 7.033.000 lekë*

(50,000 euro *140.66 lekë/euro). Në fund të vitit ushtrimor në mbyllje të rezulttit financiar dhe hartimit të pasqyrave financiare të vitit 2014 janë bërë veprimet kontabël rregulluese të llogarive analitike në llogarinë sintetike *** 'Të drejta dhe detyrime të ortakëve', duke kredituar llogarinë analitike *** 'Të drejta dhe detyrime të ortakëve marrë hua në shoqëri' për shumën prej 7,033,000 lekësh dhe debituar *** 'Të drejtat dhe detyrimet ndaj ortakëve', e cila në fillim të vitit ushtrimor rezultoi me teprice kreditore të mbartur nga vitet e mëparshme në shumën prej 32,250,000 lekësh. Shuma e mësipërme është e pasqyruar në pasiv të pasqyrave financiare të vitit 2013 në zërin e bilancit 'Hua të tjera', e cila në fund të vitit 2014 teprica debitore dhe kreditore në llogaritë analitike krahe të kundërt paraqitet me gjendje zero lekë.

Gjithashtu, sqarohet se jam emëruar për të kryer praktikën profesionale si studente e vitit të tretë të Shkollës së Magjistraturës, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 21.10.2013, praktikë profesionale e cila ka vijuar deri në muajin qershor të vitit 2014. Apartamenti në rrugën '***' Tiranë është blerë në datën 12.9.2014, periudhë në të cilën unë kisha përfunduar stazhin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pas diplomimit si magjistrate nga Shkolla e Magjistraturës, isha në pritje të emërimit përfundimtar. Për të provuar këtë fakt, po paraqes vërtetim të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, lidhur me statusin tim pranë kësaj gjykate.

Pra, apartamenti i ndodhur në rrugën '***' Tiranë është blerë dhe është në pronësi të babait tim P.Z. Po kështu, rezultoi tërësisht e provuar se ky apartament nuk lidhet me detyrën time si gjyqtare dhe se, bazuar në nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016, nuk kam detyrim për të justifikuar ligjshmërinë e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e apartamenteve në pronësi të tij. Ky qëndrim imi bazohet edhe në jurisprudencën tashmë të konsoliduar të Kolegjit.

Lidhur me rrethin e personave të lidhur duhet t'i referoheni vendimit nr. 20, datë 8.9.2020 dhe nr. 21, datë 10.9.2020, të Kolegjit".

5.8 Në përfundim, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës lidhur me:

- Konstatohet se kjo pasuri është blerë nga babai i subjektit në datën 12.9.2014, pra, në periudhën e kryerjes së stazhit si gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Kjo pasuri nuk është deklaruar si pasuri në përdorim pa kundërshtim.
- Personi tjetër i lidhur nuk ka provuar legjitimitetin e të ardhurave nga biznesi për blerjen e këtij apartamenti në vitin 2014, në shumën 50,000 euro, apartament i cili është përdorur nga subjekti, pa kundërshtim, gjatë vitit 2014 - 2015.

Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar të drejtat reale mbi këtë pasuri në DPV-në e vitit 2014-2015.

5.9 Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti deklaroi se:

"Kjo pasuri është blerë nga babai im P.Z në vitin 2014. Babai im nuk është person tjetër i lidhur sipas pikës 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016. Ai nuk ndodhet në kushtet e dhurimit apo huas. Bazuar në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, përdorimi i pasurive të prindërve nga subjekti nuk përmbush kriteret e parashikuara nga ligji, për t'i konsideruar ato si persona të tjerë të lidhur. Kjo pasuri apartament nuk lidhet me detyrën time si gjyqtare dhe nuk ka të bëjë me ndonjë konflikt të mundshëm interesi, pasi në atë periudhë kam qenë duke kryer stazhin si gjyqtare. Kjo pasuri është deklaruar nga ana ime si adresë banimi në DPV-në e vitit 2014. Burimi i krijimit të kësaj pasurie është huaja e marrë nga shoqëria 'Z', ku babai është aksioner i vetëm dhe administrator i shoqërisë. Sipas statementeve bankare rezultoi se nga llogaria e shoqërisë 'Z' janë kaluar fondet për blerjen e pasurisë apartament në llogarinë e babait në shumën prej 50,000 euro. Për kryerjen e veprimeve financiare të shoqërisë është hartuar dhe

një raport nga audituesi ligjor, z. A. M. Sipas audituesit veprimet financiare për dhënien e huas janë regjistruar dhe kontabilizuar në librat kontabël të shoqërisë”.

Vlerësimi i Komisionit

5.10 Subjekti i rivlerësimit ka përdorur në vitin 2014, pa kundërshtim, pasurinë apartament në Tiranë, të regjistruar në emër të babait të saj. Këtë pasuri subjekti e ka deklaruar edhe si adresë banimi në DPV-në për vitin 2014.

5.11 FSHU-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 14.5.2020, ka konfirmuar se shtetasi P.Z, referuar sistemit të faturimit indentifikohet abonent me kontratën e furnizimit me nr. *** në instancën Tiranë.

5.12 Është provuar gjatë hetimit se kjo pasuri është blerë nga babai i subjektit me kontratën e shitjes datë 12.9.2014, në vlerën 50,000 euro. Bazuar në veprimet bankare¹⁸ rezultoi se më 12.9.2014 nga llogaria e shoqërisë “Z” sh.p.k. ka kaluar shuma prej 50,000 euro në llogarinë bankare të ortakut të vetëm të kësaj shoqërie, z. P.Z (babait të subjektit).

5.13 Bazuar në “njoftim-debitimi” të “Raiffeisen Bank” më 4.11.2014 është kaluar fondi prej 50,000 euro në zbatim të kontratës së shitjes nr. ***.

5.14 Bazuar në *statement of account* është kryer veprimi i debitimit të llogarisë së subjektit “Z” sh.p.k., pranë “Raiffeisen Bank” më 9.1.2014, për shumën 50,000 euro.

5.15 Veprimet e kryera nga shoqëria “Z” sh.p.k. te babai i subjektit dhe më pas të noteri për likuidimin e detyrimit kontraktor për blerjen e pasurisë apartament janë të rregullta dhe të provuara me anë të veprimeve bankare.

5.16 Komisioni konstatoi se shuma prej 50,000 euro (burimi i krijimit të pasurisë në përdorim në vitin 2014 nga subjekti) është marrë në formë huaje nga shoqëria “Z” sh.p.k., e cila përkon me dhënien e fondeve ortakut të vetëm P.Z.

5.17 Komisioni konstatoi se kjo shoqëri ka ndjekur procedurat dhe veprimet e kryera për dhënie huaje në shumën prej 50,000 euro dhe jo për shpërndarjen e dividendit nga fitimi i shoqërisë.

5.18 Bazuar në raportin e audituesit të pavarur rezultoi se veprimi bankar për kalimin e vlerës prej 50,000 euro është kontabilizuar në librat kontabël të shoqërisë dhe kontabilizimi i paraqitur në ditarin e bankës të vitit 2014, korrespondon me një veprim dhënie huaje ndaj ortakut dhe si rezultat i kësaj huaje në vlerën 50,000 euro, duhet të jetë pasqyruar në pasqyrat financiare të shoqërisë si veprim i kryer në vitin 2014.

5.19 Xhiroja e shoqërisë “Z” sh.p.k., për vitin 2014, nga pasqyrat financiare rezultoi në shumën 62,857,603 lekë. Bazuar në statementin bankar¹⁹ gjendja e llogarisë në “Raiffeisen Bank” e shoqërisë para huadhënies ishte në shumën 57,406,75 euro.

5.20 Komisioni, pas shpjegimeve të dhëna nga subjekti, pas rezultateve të hetimit dhe pas analizimit të provave të administruara të paraqitura nga subjekti, doli në konkluzionin se: *Kontabilizimi nga shoqëria “Z” sh.p.k., e veprimit të dhënies hua ndaj ortakut P.Z, përbën një*

¹⁸Shihni veprimet pranë “Raiffeisen Bank” në praktikën e administruar nga Komisioni.

¹⁹Shihni shkresën e “Raiffeisen Bank” në dosjen e Komisionit.

pasqyrim të saktë të realitetit dhe situatës financiare. Për pasojë, ky veprim nuk ka sjellë dhe nuk mund të sjellë në të ardhmen shmangie të detyrimeve tatimore.

5.21 Bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 31.5.2021, rezultoi se subjekti i rivlerësimit Atalanta Zeqiraj ka kryer stazhin profesional si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për periudhën 21.10.2013 – 25.9.2015. Pra, Komisioni konstatoi se periudha e blerjes së pasurisë nga babai i subjektit përkon me periudhën e fillimit të ushtrimit të stazhit.

5.22 Bazuar në pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës ku parashikohet se: “... pasuri të ligjshme për qëllime të ligjit konsiderohen të ardhurat e deklaruara për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Për qëllime të procesit të rivlerësimit si të ardhura të ligjshme duhen konsideruar vetëm të ardhurat, të cilat plotësojnë në mënyrë kumulative dy kritere: (i) janë të deklaruara; (ii) për të cilat vërtetohet pagimi i detyrimeve tatimore sipas legjislacionit në fuqi”.

5.23 Dhënia e fondeve nga shoqëria “Z” sh.p.k., për blerjen e pasurisë apartament në përdorim nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2014 dhe reflektimi i kësaj huaje në librat kontabël të shoqërisë dhe pastaj në pasqyrat financiare nuk ka sjellë shmangie të detyrimeve tatimore, pavarësisht së veprimi i përfitimit të shumës prej 50,000 euro nuk është bërë duke shpërndarë fitimin (dividendin) në fund të vitit përkatës. Komisioni konstaton se ky veprim është përfshirë në dokumentet kontabël të shoqërisë si hua e dhënë që do të thotë se është kontabilizuar si vlerë brenda bilancit të shoqërisë për të cilën në të ardhmen do të paguhet detyrimet përkatëse në buxhetin e shtetit (në kohën kur do të shpërndahet fitimi i shoqërisë).

5.24 Në përfundim, Komisioni ka marrë në konsideratë faktet dhe rrethanat, si vijojnë:

i) Përfitimin nga babai i subjektit dhe përdorimin e kësaj pasurie nga subjekti në vitin 2014, periudhë kur znj. Atalanta Zeqiraj kryente stazhin si gjyqtare, si dhe faktin që në DPV-në për këtë vit subjekti e ka deklaruar adresën e kësaj pasurie si adresë vendbanimi.

ii) Veprimet e kryera dhe të reflektuara nga shoqëria “Z” sh.p.k. në librat përkatës në lidhje me huan që kjo shoqëri i ka dhënë ortakut të vetëm P.Z.

iii) Kryerjen e të gjitha veprimeve në rrugë bankare si nga ana e shoqërisë “Z” sh.p.k. si person juridik ashtu edhe nga ana e administratorit të saj si individ.

iv) Qarkullimin dhe mjetet e lira monetare në vlera të konsiderueshme të shoqërisë “Z” sh.p.k.

Komisioni krijoi bindjen se për këtë pasuri të blerë nga babai i subjektit të rivlerësimit nuk ka problematika dhe dyshime dhe nuk u evidentua asnjë lidhje e subjektit të rivlerësimit me këtë pasuri. Veç kësaj, në analizë të çdo deklarimi të subjektit, si dhe provave shkresore të administruara, nuk mund të arrihet në konkluzionin që babai i tij nuk pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e pasurisë, e aq më tepër që këto të ardhura të kenë qenë të subjektit të rivlerësimit.

6. Lidhur me deklaratet e anëtarëve të familjes së subjektit

6.1 Në deklaratat periodike vjetore për vitet 2013 – 2016, subjekti ka deklaruar përbërjen familjare, por nuk ka deklaruar pasurinë e të gjithë pjesëtarëve të familjes që rezultojnë në përbërjen familjare.

6.2 Subjekti u pyet dhe iu kërkua të sqarojë se pse nuk është deklaruar pasuria e të gjithë pjesëtarëve të familjes në DPV-të përkatëse, si dhe pse nuk është plotësuar formulari i deklaratimit nga bashkëjetuesi sipas deklaratës para fillimit të detyrës në vitin 2013 dhe në DPV-në për vitin 2013.

6.3 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti deklaroi:

“Detyrën si gjyqtare e kam filluar me dekretin e datës 21.10.2013 dhe kam plotësuar deklaratën para fillimit të detyrës. Më pas kam kryer deklarin periodik vjetor në muajin mars 2014, për vitin 2013. Në kohën e plotësimit të deklaratës para fillimit të detyrës dhe deklaratës periodike vjetore, ka qenë në fuqi ligji nr. 9049, datë 10.4.2003 ‘Për deklarin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë’ (ndryshuar me ligjin nr. 85/2012, datë 18.9.2012). Sipas ligjit nr. 85/2012 me të cilin u ndryshua ligji nr. 9049, datë 10.4.2003 dhe konkretisht neni 7 pika 5 e tij, përcaktohet se: “... 5. Për këtë qëllim të deklarin periodik vjetor, sipas pikave të mësipërme të këtij neni, ndër personat e lidhur me zyrtarin, mbartin detyrim për deklarin vetëm bashkëshorti/ja dhe fëmijët madhorë’. Pra, në ligj është përcaktuar detyrimi për të deklaruar vetëm për bashkëshortin dhe fëmijën madhor. Kështu prindërit, motra dhe vëllai im janë pasqyruar në pjesën që kërkon të plotësohet përbërja familjare sipas certifikatës së gjendjes civile. Por, sipas ligjit në fuqi nuk kanë pasur detyrim që të plotësonin deklaratë periodike vjetore.

Po kështu, sipas deklaratës vjetore periodike të vitit 2013 (dorëzuar në mars të vitit 2014) janë pasqyruar tek rrethi i personave të lidhur prindërit e mi dhe bashkëjetuesi. Sikurse përcaktohet në deklaratë (f.2 e deklaratës), pasqyrimi i tyre është në funksion të kufizimit të interesave për konfliktin rast pas rasti dhe të vazhdueshëm. Nga ligji nr. 85/2012 me të cilin u ndryshua ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, rezulton se bashkëjetuesi nuk ka qenë në rrethin e subjekteve që duhet të plotësonin deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës dhe atë periodike vjetore për vitin 2013.

Ndërsa detyrimi i bashkëjetuesit tim ka lindur me ndryshimin e ligjit në vitin 2014, me ligjin nr. 45, datë 24.4.2014, i cili ka ndryshuar ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 ‘Për deklarin dhe kontrollin e pasurive ...’.

6.4 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i vlerësoi bindëse deklarinet e subjektit dhe çmoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur detyrimin ligjor për deklarin e pasurive të pjesëtarëve të familjes (prindërve, motrës dhe vëllait) në deklaratat periodike vjetore 2013 – 2016.

6.5 Bashkëjetuesi i subjektit ka deklaruar në deklaratat periodike pas lindjes së detyrimit ligjor, përkatësisht pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 45, datë 24.4.2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003”.

6.6 Nuk janë konstatuar problematika lidhur me deklarinet e anëtarëve të familjes së subjektit të rivlerësimit.

7. Lidhur me dhurimet

7.1 Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar të ardhura nga babai i saj (transfertë nga babai P.Z) në shumat 100,000 + 50,000 + 50,000 lekë (totali 200,000 lekë).

7.2 Në deklaratën periodike për vitin 2014 rezultoi se nga subjekti nuk është deklaruar e gjithë shuma e dhuruar prej 200,000 lekësh.

7.3 Për këtë u pyet subjekti që të deklarojë shprehimisht pse nuk janë deklaruar të gjitha këto dhurime në DPV për vitin 2014, ku të provojë dhe të dokumentojë mundësitë financiare të babait për këto dhurime.

7.4 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti deklaroi:

“Lidhur me kalimet nga babai, po sqaroj se në deklaratën periodike vjetore në muajin mars të vitit 2015 kam pasqyruar kalimet nga babai, konkretisht në datën 17.9.2014, në vlerën 100,000 lekë dhe në datën 10.7.2014, në vlerën 50,000 lekë (si ndryshime të ndodhura në vitin 2014 janë pasqyruar në DPV-në e vitit 2015). Nga statement më rezulton se im atë më ka kaluar në

datën 10.12.2014, shumën prej 50,000 lekësh. Nga DPV-ja për vitin 2014, dorëzuar në mars të vitit 2015, konstatohet se nuk kam deklaruar shumën prej 50,000 lekësh të kaluar nga babai im në datën 12.10.2014. Kjo përbën harresë nga ana ime dhe nuk kam pasur si qëllim të mos e deklaroj, pasi është kryer me bankë, konkretisht kalim në llogarinë bankare, nga babi im P.Z, i cili më ka ndihmuar edhe herë të tjera duke bërë kalime nëpërmjet sistemit bankar.

Lidhur me mundësitë financiare të babait për të më kaluar shumën 100,000+50,000 +50,000 lekë, po shpjegoj se shuma prej 100,000 mijë lekë është kryer me kalim nga llogaria e tij personale tek llogaria ime. Për të provuar këtë po paraqes statement nga e cila rezulton kryerja e veprimit nga babi im. Konkretisht nga llogaria e P.Z pranë 'Raiffeisen Bank' në datën 17.9.2014 është kaluar shuma prej 100,000 lekësh për Atalanta Zeqiraj. Në datën 10.7.2014 dhe më 10.12.2014 ka derdhur cash babai im (50,000+50,00 lekë). Sikurse kam sqaruar, babai im është ortak i vetëm dhe administrator i shoqërisë 'Z' sh.p.k. dhe prej aktivitetit të shoqërisë gjeneron të ardhura prej më shumë se 24 vite”.

7.5 Gjithashtu, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar disa ndihma financiare të dhëna nga babai. Disa prej tyre rezultoi se kanë kaluar me transfertë bankare nga llogaria e tij personale dhe disa të tjera janë derdhur cash në llogarinë personale të subjektit.

7.6 Komisioni i kërkoi subjektit të vërtetojë me dokumentacion provues mundësinë financiare të babait për dhurimin e shumave të mëposhtme, të cilat janë deklaruar nga subjekti si kalime/dhurime në favorin e saj dhe konkretisht:

- në datën 13.6.2013 shumën 50,000 lekë;
- në datën 16.9.2013 shumën 40,000 lekë;
- në datën 17.9.2014 shumën 100,000 lekë;
- në datën 10.7.2014 shumën 50,000 lekë; dhe
- në datën 10.12.2014 shumën 50,000 lekë.

7.7 Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se:

“Lidhur me dy kalimet e para, përkatësisht atë të datës 13.6.2013 në shumën 50,000 lekë dhe atë të datës 16.9.2013 në shumën 40,000 lekë, janë para fillimit të detyrës (detyrën e kam filluar më datë 21.10.2013). Lidhur me burimin e ligjshëm të babait tim, sikurse kam shpjeguar të adhuruat janë gjeneruar nga ushtrimi i aktivitetit të ligjshëm të shoqërisë dhe nga gjendja cash që ka pasur sipas nevojave të mija ka kryer edhe kalimet bankare të mësipërme.

Lidhur me të ardhurat e babait para fillimit të detyrës sime dhe kalimet bankare, po i referohem vendimit nr. 331 datë 11.1.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ku arsyetohet se: ‘... trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar në dosje dhe provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, vlerëson faktin se krijimi i të ardhurave dhe blerja e pasurisë apartament, janë veprime që kanë ndodhur përpara se subjekti të merrte detyrën e gjyqtarës dhe çdo burim i përdorur për krijimin e kësaj pasurie është krijuar nga familjarë të saj, përpara se subjekti të fillonte detyrën si gjyqtare. Për këto arsye, balanca negative që rezultoi nga analiza financiare, nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi disiplinore subjektin e rivlerësimit’.

Lidhur me kalimin e shumës prej 100,000 lekësh, nga statement i vendosur në dispozicion nga babai im, më rezulton se në datën 17.9.2014, tek administratori P.K.Z shuma prej 100,000 lekë me përshkrim ‘kalim tek administratori’. Po në datën 17.9.2014, babai im i kaluar në llogarinë time sipas përshkrimit përkatës. Lidhur me këtë sqarim po vendos në dispozicion nxjerrje llogarie personale për klientin P.K.Z, për periudhën 1.1.2014 – 31.12.2015 (data e printimit 27.5.2021).

Lidhur me kalimet në datat 10.7.2014 dhe 10.12.2014, përkatësisht në shumat 50,000 lekë për secilin prej kalimeve, më rezulton se, ato janë derdhur cash nga babai im në llogarinë time personale. Sipas shpjegimeve të babait, këto kalime janë kryer nga gjendja cash që ai ka pasur për shkak se kryente tërheqje të vazhdueshme nga shoqëria sipas nevojave konkrete. Shpjegime të detajuara në lidhje me llogarinë e ortakut në vitin 2014, janë dhënë në përgjigje të pyetjes nr. 1 të këtij pyetësi”.

7.8 Bazuar në dokumentet dhe veprimet bankare lidhur me dhurimet rezultoi:

- Nga *statement-i* bankar në “Raiffeisen Bank” të llogarisë së shoqërisë “Z” sh.p.k., rezulton se në datën 17.9.2014, z. P.Z tërheq shumën 100,000 lekë me përshkrimin “kalim tek administratori”.

- Në të njëjtën datë nga llogaria personale e z. P.Z bëhet një kalim me vlerën 100,000 lekë në llogarinë e subjektit me përshkrimin “kalim në llogari për shpenzime familjare”.

- Nga *statement* bankare në “Credins Bank” të llogarisë së subjektit rezulton se në datën 10.7.2014, z. P.Z ka derdhur në llogari të subjektit shumën 50,000 lekë.

- Nga *statement* bankare në “Credins Bank” të llogarisë së subjektit rezulton se në datën 10.12.2014, z. P.Z ka derdhur në llogari të subjektit shumën 50,000 lekë.

7.9 Në përfundim Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, lidhur me:

- Subjekti nuk ka deklaruar saktë vlerat e dhurimit në DPV-në e vitit 2014.

- Mbetet e paprovuar mundësia financiare e babait të subjektit lidhur me shumat e dhuruara.

7.10 Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti deklaroi se:

“Në vitin 2014 shuma e dhuruar nga babai është në vlerën totale prej 200,000 lekësh. Veprimet e dhurimit janë bërë nëpërmjet sistemit bankar (llogaria e babait në ‘Credins Bank’). Burimi kanë qenë të ardhurat e babait nga aktiviteti tregtar si ortak i vetëm i shoqërisë ‘Z’ sh.p.k.”

Vlerësimi i Komisionit

7.11 Komisioni konstatoi se babai dhe nëna e subjektit kanë përfituar të ardhura nga puna, për të cilat janë paguar edhe detyrimet përkatëse.

7.12 Referuar shkresës nr. *** prot., datë 14.5.2020, të DPT-së rezultoi se babai i subjektit të rivlerësimit, z. P.Z, është deklaruar në listëpagesa si administrator i shoqërisë “Z” sh.p.k., me pagë në masën prej 40,000 lekë/muaj.

7.13 Komisioni kreu analizën financiare lidhur me mundësitë e prindërve të subjektit për dhurimet e kryera ndaj subjektit në shumën prej 200,000 lekësh në vitin 2014. Të dhënat e marra në konsideratë (të ardhurat nga pagat, kontributet e sigurimeve, shoqërore dhe shëndetësore dhe TAP), i referohen shkresës së sipërpërmendur të DPT-së për vitet 2012 – 2014.

7.14 Analiza e mundësisë së dhurimit të vlerës 200,000 lekë në vitin 2014

Të ardhura <i>bruto</i> P. dhe V. Z., periudha 2012 – 2014	2,005,000
Kontribute Sig. Shoq.+ Shend., periudha 2012 – 2014	224,560
TAP - 2012 – 2014	127,500
Të ardhura <i>neto</i> nga puna 2012 – 2014	1,652,940
Shpenzime jetese për 2 persona për periudhën 2012 – 2014	1,001,140

Dhuruar subjektit – 2014	200,000
Mundësi kursimi	451,800

7.15 Bazuar në analizën financiare, rezultoi se babai dhe nëna e subjektit ka pasur mundësi financiare për dhënien e shumës prej 200,000 lekësh në formën e dhurimit në vitin 2014.

7.16 Si përfundim, Komisioni konstatoi se subjekti ka deklaruar saktë në deklaratën *Vetting* dhurimet e dhëna nga babai në vlerën prej 200,000 lekësh në vitin 2014 dhe u provua mundësia financiare për këtë dhurim nga personi tjetër i lidhur.

8. Shpenzimet e studimit

8.1 Në DPV-në për vitin 2014 subjekti ka deklaruar shpenzime të bashkëjetuesit në shumën prej 2,900 euro (shpenzime studimi).

8.2 Lidhur me këtë i është kërkuar subjektit të deklarojë burimin e ligjshëm të këtij shpenzimi dhe të provojë me dokumente shkresore të gjitha shpenzimet e studimeve të bashkëjetuesit duke i ndarë sipas viteve përkatëse.

8.3 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar:

“Bashkëjetuesi im, Sh.Xh, ka kryer studimet ‘Bachelor’ në Inxhinieri Elektronike në Universitetin Privat ‘A.U’, sistemin trevjeçar. Nga faturat e vendosura në dispozicion, lidhur me shkollimin është kryer pagesë në datën 18.10.2011, në vlerën 250 euro (ky shpenzim është kryer para fillimit të detyrës sime si gjyqtare). Prej datës 3.2.2011 – 1.11.2011 kam marrë pagë (paga kreditohej në ‘Credins Bank’) si punonjëse pranë Ministrisë së Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve dhe përballonim jetesën në momentin e parë që kemi filluar bashkëjetesën në qytetin e Tiranës, duke shlyer edhe këtë detyrim me qëllim shkollimin.

Në datën 15.2.2013, është paguar vlera prej 500 euro (shpenzim i kryer para fillimit të detyrës sime si gjyqtare, të cilën e kam filluar në datë 21.10.2013). Në datën 17.6.2013, në vlerën 750 euro (shpenzim i kryer para fillimit të detyrës sime si gjyqtare, të cilën e kam filluar më datë 21.10.2013 në datën 21.6.2013, në vlerën 100 euro (shpenzim i kryer para fillimit të detyrës sime si gjyqtare, të cilën e kam filluar në datën 21.10.2013). Si burim për kryerjen e pagesave kanë shërbyer të ardhurat që realizonim unë dhe bashkëjetuesi im, si dhe kalime që babai im ka kryer në vitin 2013 para fillimit të detyrës si dhuratë në favorin tim. Lidhur me të ardhurat tona janë vënë në dispozicion statement nga bankat ku kalonte paga. Po kështu, në vitin 2013 (para fillimit të detyrës) në datën 13.6.2013 ka derdhur në llogarinë time në ‘Raiffeisen Bank’ (llogari e hapur për shkak të bursës së Shkollës së Magjistraturës) shumën prej 50,000 lekësh, babai im P.Z. Ndërsa në datën 16.9.2013, shumën prej 40,000 lekësh (nga babai P.Z). Në këtë periudhë të ardhurat e realizuara nga të dy dhe ndihmat e vogla të babait tim në favorin tim, na kanë ndihmuar të përballojmë jetesën.

Në vitin 2014, janë paguar në datën 11.2.2014, vlera prej 50 euro, si dhe 1,400 euro, më 4.6.2014, në vlerën prej 1450 euro. Pra, në total për vitin 2014 janë paguar 2,900 euro. Rezulton se në vitin 2014, unë kam punuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kam realizuar të ardhura të cilat janë deklaruar në DVP-në e vitit 2014. Ndërsa, bashkëjetuesi ka punuar pranë ‘A.C’ sh.a., duke realizuar të ardhura për vitin 2014. Nga të ardhurat e përbashkëta të realizuara, kemi shlyer detyrimin për shkollim.

Bashkëngjitur, do të gjeni, kopje të vërtetimit nga ‘A.U’, datë 11.12.2019, (originali është paraqitur me përgjigjet e pyetjeve standard), në formën origjinale e faturave janë paraqitur me përgjigjet e pyetjeve standard edhe depozitimet e pagesës në ‘Alpha Bank’ në datën

11.2.2014 (gjithësej dy fatura në këtë datë) dhe në datën 4.6.2014. Po kështu, do të gjeni edhe faturat e datës 18.10.2011, datë 15.2.2013, datë 17.6.2013 dhe datë 21.6.2013.

Lidhur me të ardhurat kam depozituar statement 'Intesa Sanpaolo Bank' original për bashkëjetuesin me përgjigjet e pyetësorit standard (prej datës 5.12.2012). Po kështu, me pyetësorin standard janë paraqitur edhe statement original lidhur me kalimin e pagës sime.

Ky shpenzim është deklaruar në deklaratën vjetore periodike vjetore të vitit 2014, dorëzuar në muajin mars të vitit 2015 (pasi është kryer në vitin 2014). Plotësimi është kryer duke ju referuar kërkesës në pjesën e sipërme të tabelës ku është shkruar 'përshkruani hollësisht çdo lloj shpenzimi të deklarueshëm me vlerë mbi 300,000 lekë, si për arsim, mjekim shëndetësor, pushime, arredim e të tjera të këtij lloji të kryera nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit'. Pra, kërkohet të përshkruhet shpenzimi me vlerë më të lartë se 300,000 lekë, por nuk kërkohet të përcaktohet burimi”.

Konstatim i Komisionit

8.4 Gjatë hetimit administrativ, u provua se janë bërë disa pagesa të pjeshme gjatë gjithë vitit 2014 për shkollimin e bashkëjetuesit të subjektit në një vlerë totale prej 2,900 euro. Bazuar në analizën financiare²⁰ të vitit 2014, subjekti rezultoi me mundësi financiare në vlerën 585,827 lekë për shtimin e likuiditeteve dhe kryerjen e gjithë shpenzimeve, përfshirë këtu edhe shpenzimet e studimit.

8.5 Nga përgjigjet dhe provat e sjella nga subjekti nuk u konstatuan problematika lidhur me këtë deklaram dhe shpenzimet e kryera për studime.

9. Konflikti i interesit

9.1 Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit dhe babai P.Z kanë qenë në një përbërje familjare deri në datën 28.9.2016. Më pas subjekti ka bërë shkëputje nga trangu familjar.

9.2 Babai i subjektit është ortak i vetëm dhe administrator i shoqërisë “Z” sh.p.k. me status aktiv, regjistruar në datën 4.7.1996, me NIPT ***, me aktivitet “gërmime dheu, muratore dhe betonarme, prishje dhe punime toke”.

9.3 Rezultoi se gjatë periudhës 2014 – 2018, shoqëria “Z” sh.p.k., ka marrë pjesë dhe përfituar disa prokurime me fonde publike. Bazuar në veprimet bankare të kësaj shoqërie rezultuan disa pagesa nga institucione shtetërore të ndryshme me burim përdorim të fondeve publike.

9.4 Referuar ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, në nenin 21, pika 1 përcaktohet se: “Asnjë individ, kur ky njësohet me një zyrtar në njërin nga funksionet e përcaktuara në kreun III, seksioni 2 të këtij ligji, gjyqtarët e prokurorët në nivelin e gjykatës së shkallës së parë e në atë të apelit, dhe asnjë shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri e thjeshtë, ku ky zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo pasive, aksione a pjesë në kapital, në çfarëdo sasive, nuk mund të lidhë kontratë ose nënkontratë me asnjë institucion publik”.

9.5 Në nenin 24, pika 1, të këtij ligji përcaktohet se: “Rrethi i personave të lidhur me zyrtarin, në zbatim të ndalimeve të përcaktuara në nenin 21 dhe në nenin 22 të këtij ligji, përbëhet nga

²⁰Shihni analizën financiare në pikën 10.9 të këtij vendimit.

bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja fëmijët në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es”.

9.6 Në interpretim të neneve të sipërcituara rezulton se asnjë shoqëri tregtare, ku gjyqtarët dhe personat e lidhur të zotërojnë në mënyrë aktive aksione në çfarëdo sasive, nuk mund të lidhin kontrata me institucione publike.

9.7 Një ndalim i tillë është bërë me ligjin nr. 44/2014, datë 24.4.2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” të ndryshuar.

9.8 Ky ligj ka hyrë në fuqi në datën 3.6.2014. Pra, sipas ndryshimeve të ligjit rezulton se çdo kontratë e lidhur me institucione publike nga data 3.6.2014, është në shkelje të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, me ndryshimet përkatëse.

9.9 Referuar veprimeve (statement bankar) duket se shoqëria “Z” sh.p.k., ku babai i subjektit është ortak i vetëm ka përfituar fonde publike dhe burimi i fondeve për shërbimet e ndryshme ka qenë buxheti i shtetit, të cilat kanë kaluar nëpërmjet degës së thesarit.

9.10 Në përfundim të hetimit administrativ, dukej se subjekti ishte në shkelje të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

9.11 Për këtë arsye, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit, duket se babai i saj ka qenë dhe ka ushtruar veprimtarinë si ortak i vetëm i shoqërisë “Z” sh.p.k., në kushtet e konfliktit të interesit, duke përfituar fonde publike të buxhetit të shtetit.

9.12 Në ushtrim të barrës së provës, në parashtrimet e saj, subjekti deklaroi:

*“Për herë të parë jam njoftuar nga ILDKPKI-ja në datën 20.5.2021 dhe më 27.5.2021 jam vënë në dijeni për herë të parë lidhur me rrethanën e konfliktit të interesit. Menjëherë kam kontaktuar me babanë tim, pasi është një rrethanë që lidhet me të dhe babai im pas rreth 25 vitesh i ka dhuruar kuotat tek A.Z, i cili nuk është person i lidhur me mua. Kam marrë të gjitha masat për të zgjidhur këtë situatë të ndaluar sipas ligjit, por unë personalisht nuk kam qenë në situatën e konfliktit të interesit. Për të përcaktuar nëse ndodhem në kushtet e konfliktit të interesit duhet t’i referohemi ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005. Nuk kam zhvilluar asnjë gjykim me institucione me të cilat babai im ka lidhur kontrata publike, e cila mund të krijonte konfliktin në dukje të interesit. Lidhur me këtë situatë sjell në vëmendje vendimin nr. ***, datë 8.7.2019, të Komisionit”.*

Vlerësimi i Komisionit

9.13 Mënjanimi apo parandalimi i konfliktit të interesit nga zyrtari lidhet me dijeninë e tij për situatën dhe rrethanën që e krijon atë. Gjendur në këto kushte, subjekti duhet të kishte dijeni për dispozitat ligjore në fuqi për konfliktin e interesit dhe duhet të kishte marrë masa për shmangien e një situatë konflikti të mundshëm interesi që në momentin e miratimit të ligjit nr. 44/2014, datë 24.4.2014, i cili ka hyrë në fuqi në datën 3.6.2014.

9.14 Rezultoi se me kontratën e dhurimit të datës 27.5.2021 babai i subjektit P.Z ka dhuruar kuotat prej 100% të shoqërisë “Z” sh.p.k., te z. A.Z. Për kryerjen dhe finalizimin e këtij veprimi janë paraqitur si prova vendimi i asamblesë nr. ***, për dhënien e pëlqimit për dhurimin dhe vendimi nr. *** për miratimin e dorëheqjes së administratorit P.Z. Subjekti ka paraqitur si provë dhe vërtetim aplikimi për kryerjen e ndryshimeve në të dhënat e regjistrimit, si dhe në ekstraktin e QKB-së, për shoqërinë “Z” sh.p.k., ku pasqyrohet se ortak i vetëm dhe administrator është A.Z.

9.15 Pavarësisht rasteve të konstatuara, kur shoqëria “Z” sh.p.k., ka përfituar disa prokurime nga fonde publike, gjatë periudhës që subjekti ka qenë në detyrë, Komisioni vlerëson faktin që me marrjen dijani për situatën pas pyetjes nga ILDKPKI-ja, subjekti ka vepruar duke vënë në dijeni babanë, i cili ka bërë të mundur shmangien e situatës së konfliktit të interesit me anë të tjetërsimit të interesave private në shoqëri, duke hequr dorë nga kuotat e shoqërisë.

9.16 Bazuar në të gjitha faktet si më sipër, Komisioni vlerësoi se qenia e babait të subjektit në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimit të pikës 1, të nenit 24, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, si dhe ligjit nr. 44, datë 24.4.2014, nuk mund të kualifikojë subjektin e rivlerësimit në kushtet e pamjaftueshmërisë në deklarinimin e kriterit pasuror, sipas parashikimit të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 dhe të përbëjë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit të subjektit të rivlerësimit nga detyra.

10. Analiza financiare

10.1 Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në analizën financiare të vënë në dispozicion me rezultatet e hetimit administrativ, dukej se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare në shumën prej 314,723 lekësh, për shtimin e pasurive, likuiditeteve dhe mbulimin e shpenzimeve për vitet 2014 – 2016.

10.2 Analiza financiare do të ishte objekt ndryshimi në varësi të provave dhe shpjegimeve që do sillte subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit.

10.3 Në këtë analizë financiare nuk është përfshirë vlera prej 3,800,000 lekësh, çmimi i blerjes se pasurisë apartament në Vlorë nga babai i subjektit, pasuri të cilën subjekti e ka në përdorim. Nëse subjekti nuk do të arrinte të provonte burimin e ligjshëm të të ardhurave të babait të saj për blerjen e pasurisë dhe nëse do të evidentoheshin lidhje apo kontribute të subjektit të rivlerësimit me këtë pasuri, subjektit i është bërë me dije se vlera financiare prej 3,800,000 lekësh do t'i ngarkohej në analizën financiare për vitin 2015.

10.4 Gjithashtu, në këtë analizë nuk u morën në konsideratë si të ardhura të ligjshme dhurimet nga babai (5,000 euro dhe 200,000 lekë) në vitin 2014, për shkak se subjekti nuk kishte arritur të provojë burimin e ligjshëm të krijimit dhe mundësitë financiare të babait për dhurimin e këtyre shumave.

10.5 Për të gjitha gjetjet e konstatuara nga Komisioni, lidhur me analizën financiare, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat e saj, për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

10.6 Në parashtrimet e saj, subjekti paraqiti prova dhe shpjegime në ushtrim të barrës së provës, lidhur me të ardhurat, dhurimet dhe burimet e ligjshme të krijimit, sqaruar në mënyrë të hollësishme më sipër në pikat 1, 4, 5 dhe 7, të këtij vendimi.

10.7 Në përfundim të procesit, Komisioni, pas vlerësimit të të gjitha deklarimeve dhe provave shkresore që subjekti ka paraqitur, analizuar në mënyrë të hollësishme, më sipër në këtë vendim, hartoi analizën financiare lidhur me periudhën 2013 – 2016. Në analizë u morën në konsideratë si të ligjshme të ardhurat nga dhurimi i babait të subjektit në shumën prej 5,000 euro dhe 200,000 lekë në vitin 2014, si dhe burimi i ligjshëm i pasurisë apartament në përdorim nga subjekti, blerë në vitin 2015 në vlerën 3,800,000 lekë nga babai.

10.8 Analiza financiare e subjektit Atalanta P Zeqiraj

PERSHKRIMI	21.10.13 – 31.12.13	2014	2015	2016	TOTAL
-------------------	----------------------------	-------------	-------------	-------------	--------------

PASURI	66,990	847,012	-206,492	44,193	751,702
Automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa AA***KS - 5,000 euro - Sh. Xh.		700,550			700,550
Ndryshim ne likuiditet	66,990	146,462	-206,492	44,193	

DETYRIME	0	0	0	0	0
					0

PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	66,990	847,012	-206,492	44,193	751,702
----------------------------------------	---------------	----------------	-----------------	---------------	----------------

TË ARDHURA DOKUMENTUAR	210,310	2,531,154	991,037	1,144,415	4,876,916
Të ardhura nga puna subjekti Atalanta Zeqiraj	101,485	992,286	904,018	880,843	2,878,632
Të ardhura nga puna bashkëjetuesi Sh. Xh.	108,825	638,318	87,019	263,572	1,097,734
Të ardhura nga dhurimi babai P. Z. për automjet - 5,000 euro		700,550			700,550
Të ardhura nga dhurimi babai P. Z.		200,000			200,000

SHPENZIME	130,760	1,098,315	648,252	854,701	2,732,028
Shpenzime jetese	58,760	439,996	448,552	705,276	1,652,584
Shpenzime qiraje	72,000	252,000			324,000
Shpenzime arsimimi “A. U.” - 2,900 euro		406,319			406,319
Shpenzime mobilimi			50,000		50,000
Shpenzim për investim në G. E. (PF) Sh. Xh.			149,700		149,700
Shpenzime mjekësore				149,425	149,425

Analiza dokumentuar	12,561	585,827	549,277	245,521	1,393,186
----------------------------	---------------	----------------	----------------	----------------	------------------

- Rezultoi se subjekti dhe bashkëjetuesi kanë pasur burime të ligjshme për shtim pasurish dhe mbulimin e shpenzimeve gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit.

10.9 Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare

Gjatë kësaj analize, Komisioni është bazuar në:

a. Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe personave të lidhur, të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuara nga bankat e nivelit të dytë: “Raiffeisen Bank”, “Tirana Bank”, “Credins Bank”, ish-“Veneto Bank”, “Intesa Sanpaolo Bank” dhe BKT.

b. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:

i) të ardhurat nga pagat e subjektit në: Shkollën e Magjistraturës, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (2013 – 2015), Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë (2015 – 2016), si dhe nga leja e lindjes (2016);

ii) të ardhurat nga pagat e ish-bashkëjetuesit të subjektit tek “A” sh.a. (2012 – 2015), tek “F” sh.p.k. (2015), tek “T” sh.p.k. (2016), si dhe nga aktiviteti privat “G.E”;

iii) të ardhurat nga dhurimi i babait të subjektit në vlerën 5,000 euro në vitin 2014, të cilat shërbyen si burim për blerjen e automjetit nga bashkëjetuesi i subjektit;

iv) të ardhurat nga dhurimi i babait të subjektit në vlerën 200,000 lekë në vitin 2014.

c. Shpenzimet, ku përfshihen:

i) shpenzimet e jetesës bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së familjes, (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT), bashkëngjitur shkresa nr. *** prot., datë 4.3.2019, e ILDKPKI-së;

ii) shpenzime mobilimit për vitin 2015, sipas përgjigjes së subjektit në pyetësor;

iii) shpenzimet e qirasë (2013 – 2014) deklaruar nga vetë subjekti;

iv) shpenzime mjekësore tek “H.H” (2016);

v) shpenzimet arsimimi për bashkëjetuesin tek “A.U” (2014);

vi) shpenzimet për investimin tek “G.E ” (2015);

vii) Shpenzimet e arsimimit për fëmijët të deklaruar nga subjekti.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Institucioni kompetent për kontrollin e figurës, verifikimit të deklarimeve të subjektit dhe të dhënave të tjera, me qëllim përcaktimin nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me krimin e organizuar, DSIK-ja në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, pasi ka kryer të gjitha procedurat për kontrollin në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 4 dhe nenet 37 dhe 38 të ligjit nr. 84/2016, ka paraqitur në Komision raportin përfundimtar me nr. *** prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendim nr. *** , datë 26.5.2021, të KDZH-së, ku rezulton se:

- Formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në përputhje me ligjin nr. 84/2016.
- Subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës.
- Për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose persona të dyshuar të krimit të organizuar.
- Konstatohet se subjekti i rivlerësimit Atalanta Zeqiraj, është e përshtatshme për vazhdimin e detyrës.

Komisioni vlerëson se nga hetimi administrativ i kryer, nuk u gjetën elementë që të vërtetojnë përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në raste korruptive, ushtrim ndikimi të paligjshëm, si dhe që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës. Gjithashtu, nuk u konstatuan mangësi nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me plotësimin e deklaratës së kontrollit të figurës.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit Atalanta Zeqiraj, ka arritur nivel të besueshëm për kriterin e figurës.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti për vlerësimin profesional është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor si organi ndihmës, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësive profesionale;
- b) aftësive organizative;
- c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale;
- ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- 1) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit;
- 2) pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- 3) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

Gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

a) Saktësia e formularit të vetëdeklarimit

Formulari paraqitet i plotësuar sipas shtojcës së ligjit. Të gjitha rubrikat janë plotësuar me saktësi, me shkrim të qartë e të lexueshëm. Formulari është nënshkruar rregullisht në çdo faqe.

b) Përvoja profesionale në 10 vitet e fundit

Sipas formularit të vetëdeklarimit, subjekti i rivlerësimit Atalanta Zeqiraj, në periudhën tetor 2006 – korrik 2010, ka kryer Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës. Në periudhën korrik 2010 – 14.1.2011, ka qenë pa punë. Në periudhën 14.1.2011 – 5.10.2011, ka punuar në detyrën Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimeve Juridike në Ministrinë e Turizmit Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Në periudhën tetor 2011 – 30.9.2013, ka kryer studimet në Shkollën e Magjistraturës. Në periudhën 1.10.2013 – 21.10.2013, ka qenë në pritje të emërimit si gjyqtare nga ana e KLD-së. Në periudhën 21.10.2013 – 25.10.2015, ka kryer stazhin profesional si kandidate për gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga data 25 shtator 2015 dhe në vazhdim, pra, edhe aktualisht ushtron detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

c) Detyrat e kryera tri vitet e fundit dhe të dhënat statistikore

Tri vitet e fundit që i përkasin periudhës objekt i rivlerësimit profesional, subjekti i rivlerësimit Atalanta Zeqiraj, ka ushtruar detyrën e gjyqtares në dy gjykata, fillimisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë si stazhiere dhe më pas në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Gjatë ushtrimit të detyrës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për vitin 2015, subjekti ka deklaruar se i janë caktuar 83 çështje nga të cilat 63 çështje civile dhe 20 çështje penale. Për vitin 2016 i janë caktuar 272 çështje.

Gjyqtarja ka deklaruar në formularin e vetëvlerësimit se në tri vitet e fundit, ka përfunduar së gjykuari gjithsej 410 çështje, ku 65 çështje janë përfunduar gjatë vitit 2013, 66 çështje janë përfunduar në vitin 2014, 77 çështje janë përfunduar në vitin 2015 dhe 202 çështje të përfunduara në vitin 2016.

Gjyqtare Atalanta Zeqiraj ka deklaruar në formularin e vetëvlerësimit se ka mbartur për vitin 2017 gjithsej 76 çështje.

ç) Trajnimet në tri vitet e fundit

Gjyqtarja Atalanta Zeqiraj, ka qenë pjesëmarrëse në 12 aktivitete trajnuese të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës.

d) Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit Atalanta Zeqiraj, ka depozituar tri dokumente ligjore, të llojit vendim gjyqësor. Dy prej këtyre vendimeve janë të vitit 2014, ndërsa një vendim i përket vitit 2016, por që është dhënë përtej periudhës objekt rivlerësimi (përtej datës 8.10.2016). Këto vendime përshkruhen dhe analizohen në vijim:

Dokumenti 1. Vendimi gjyqësor nr. ***, datë 7.4.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, çështja civile me objekt: detyrimin e pagesave sipas kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme, datë 27.12.2013, për tatimin për fitimin.

Dokumenti 2. Vendimi gjyqësor nr. ***, datë 16.5.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, çështja civile me objekt: detyrimin e palës së paditur Korporata Elektroenergjitike Shqiptare për të dëmshpërblyer paditësin për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës.

Dokumenti 3. Vendimi gjyqësor nr. ***, datë 20.12.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, çështja civile me objekt: *“Detyrimin e palës së paditur të më bëj pagimin e diferencës lidhur me shpërblimin për vjetërsi për shkak të zgjidhjes së menjëhershme të pajustificuar të marrëdhënieve të punës”*.

PËRSHKRIMI I 5 DOSJEVE GJYQËSORE TË PËRZGJEDHURA ME SHORT

Dosja 1. Çështja penale nr. *** regjistri themeltar, datë 4.8.2016 regjistrimi, me objekt: Vleftësim arresti në flagrancë, caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg” dhe gjykimin e drejtpërdrejt të shtetasit M.H, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “drejtim i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 5.8.2016.

Vendimi gjyqësor i dhënë nga gjyqtare Atalanta Zeqiraj, është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë në datën 10.8.2016, brenda 5 ditëve nga shpallja, duke respektuar afatin 5-ditor të parashikuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale. Çështja është menaxhuar shumë mirë nga ana e gjyqtarës Atalanta Zeqiraj, e cila ka kryer veprimet procedurale të nevojshme për zgjidhjen e çështjes. Vendimi i mësipërm ka marrë formë të prerë, pa u ankimuar nga asnjëra palë.

Dosja 2. Çështja penale nr. *** regjistri themeltar, datë 4.8.2016 regjistrimi, me objekt: “vlerësim i arrestimit dhe caktim i masës së sigurimit për shtetasin A.F”, i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/a/4 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 5.8.2016.

Nuk konstatohet asnjë mangësi nga gjyqtare Atalanta Zeqiraj në menaxhimin e çështjes dhe kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme për zgjidhjen e çështjes. Vendimi gjyqësor nr.***, datë 5.8.2016, është dhënë nga gjyqtare Atalanta Zeqiraj, në cilësinë e gjyqtarit të vetëm. Vendimi përmban elementët e nenit 245 të Kodit të Procedurës Penale dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

Dosja 3. Çështja civile nr. *** regjistri themeltar, datë 27.7.2016 regjistrimi, që u përket palëve: paditësit S.Sh, kundër të paditurit OSHEE, me objekt: “pavlefshmëri e titullit ekzekutiv në formën e faturës tatimore”, përfunduar me vendimin nr. ***, datë 26.9.2016.

Vendimi gjyqësor i dhënë nga gjyqtare Atalanta Zeqiraj, është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në datë 29.9.2016, brenda 3 ditëve nga shpallja, pra, në respektim të afatit 10-ditor të parashikuar nga neni 308 paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Civile. Kohëzgjatja e gjykimit është në respektim të afatit standard 6-mujor të përcaktuar germa “e”, pika 5, e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Rrjedhimisht është respektuar standardi i procesit të rregullt ligjor, i parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Konstatohet se procesi është menaxhuar në mënyrë korrekte nga ana e gjyqtares.

Dosja nr. 4. Çështja penale nr. *** regjistri themeltar, datë 31.1.2014 regjistrimi, në ngarkim të të pandehurve K.C, Xh.P e D.M, të akuzuar për kryerjen e veprës penale të “vjedhje në bashkëpunim dhe më shumë se njëherë”, e parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal, përfunduar me vendimin nr. ***, datë 11.4.2014.

Vendimi u shpall në datën 11.4.2014, ora 13:00 dhe kundër vendimit të mësipërm ka ushtruar ankim prokurori duke kërkuar ndryshimin e tij për të pandehurin K. C. dhe mosaplikimin e nenit 59 të Kodit Penal ndaj tij, si dhe i pandehuri XH. P., duke kërkuar dënimin e tij vetëm me kohën e paraburgimit. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 17.6.2015, ka vendosur: “lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 11.4.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

Rezultoi se vendimi gjyqësor është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 21.4.2014, pra, në tejkallim të afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Është respektuar standardi i procesit të rregullt ligjor i parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Konstatohet se gjyqtarja ka menaxhuar mirë çështjen duke përfunduar gjykimin brenda afatit standard të gjykimit. Ndërkohë, vetëm seanca e parë u zhvillua me regjistrim audio. Nuk dihen arsyet se përse nuk u përdor regjistrimi audio në seancat e tjera.

Dosja 5. Çështja civile nr. *** regjistrimi, datë 23.12.2013 regjistrimi, që i përket: kërkueses L.H, me objekt: “kërkojmë dhënien e autorizimit për tjetërsimin e pasurisë me nr. *** me sip. 2310 m²”, e përfunduar me vendimin përfundimtar nr. ***, datë 31.1.2014.

Vendimi u shpall në datën 31.1.2014, ora 12:15 dhe ky vendim ka marrë formë të prerë pa u ankimuar. Organizimi dhe planifikimi i punës nga ana e gjyqtares ka qenë korrekt.

TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLGJ-SË

Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, konstatohet se gjyqtare Atalanta Zeqiraj ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 12.7.2010 dhe titullin “magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2014. Pas studimeve, në datën 25.9.2015, znj. Atalanta Zeqiraj është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ku vazhdon edhe aktualisht.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Atalanta Zeqiraj janë paraqitur 3 ankesa (2 në vitin 2014, dhe 1 ankesë në vitin 2016) në Inspektoratin e KLD-së.

Të tria ankesat (dy të vitit 2014 dhe një e vitit 2016) janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, ndër të cilat një ankesë me arsyetimin se është jashtë kompetencave të shqyrtimit të ish-KLD, një ankesë me arsyetimin se mund të zgjidhen përmes apelimit gjyqësor, si dhe një ankesë me arsyetimin se është ankesë e përsëritur më parë.

Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Atalanta Zeqiraj, përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

Analiza e gjetjeve

Subjekti i rivlerësimit gjyqtare Atalanta Zeqiraj, ka aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Gjyqtarja Atalanta Zeqiraj, përgjithësisht, kualifikon drejt marrëdhënien juridiko-civile objekt shqyrtimi gjyqësor. Vetëm në një rast, kualifikimi i marrëdhënies juridike është vlerësuar i gabuar nga gjykatat më të larta (shihni analizën e dokumentit nr. 2). Gjyqtarja kur është rasti i referohet në zgjidhjen e çështjes jurisprudencës së gjykatave më të larta të vendit përfshirë këtu Gjykatën Kushtetuese, Gjykatën e Lartë sidomos praktikat unifikuese të kësaj të fundit, madje edhe jurisprudencës së GJEDNJ-së.

Në të drejtën procedurale penale, gjyqtarja respekton të drejtën e të pandehurit për të pasur avokat mbrojtës në gjykim, merr masa dhe garanton të drejtën e të miturit për të pasur domosdoshmërisht avokat edhe kur nuk e ka zgjedhur vet një të tillë, madje siguron edhe prezencën e psikologut gjatë gjykimit të një të mituri, aplikon kur është rasti gjykimin e posaçëm (gjykimin e shkurtuar), si dhe ka njohuri të mira në caktimin e masave të sigurimit personal.

Në të drejtën civile e procedurale civile, gjyqtarja njeh dhe zbaton drejt dispozitat e Kodit Civil mbi përmbushjen e detyrimit që buron nga ligji apo kontrata, si dhe dispozitat për begatimin pa shkak (shihni dokumentin nr. 1), ndërkohë që shfaq njohuri shumë të mira edhe lidhur me titujt ekzekutivë dhe pavlefshmërinë e tyre.

Në të drejtën familjare, njeh dhe zbaton saktë dispozitat e Kodit të Familjes mbi lëshimin e autorizimit për prindin ose kujdestarin, lidhur me dhënien e autorizimit për tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme.

Vetëm një vendim u cenua për mënyrën e zgjidhjes së çështjes (shihni dokumentin nr. 2).

Subjekti i rivlerësimit Atalanta Zeqiraj, ka aftësi shumë të mira në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj, janë të qarta, të kuptueshme, qëndrimi i mbajtur lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes jepet i argumentuar, provat e marra në shqyrtim jo vetëm citohen, por edhe tregohet se çfarë u provua me përmbajtjen e tyre. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse, i jepet përgjigje ligjore pretendimeve apo prapësimeve/kundërshtimeve të palëve të parashtruara gjatë gjykimit, duke treguar se gjyqtarja ka qenë e vëmendshme ndaj kërkesave të tyre. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

Gjyqtare Atalanta Zeqiraj, në periudhën objekt i këtij vlerësimi profesional (8.10.2013 – 8.10.2016), ka punuar vetëm dy vjet. Kështu, ajo ka punuar si kandidate për magjistrate,

gjuqtare provizore, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në periudhën tetor 2013 – gusht 2014 dhe në periudhën 25.9.2015 – 10.10.2016, ka punuar si gjuqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Ndërkohë, në periudhën gusht 2014 – shtator 2015, znj. Atalanta Zeqiraj, pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës, ka qëndruar në periudhë pritjeje për të marrë emërimin përfundimtar si gjuqtare. Lidhur me ngarkesën sasiore, subjekti i rivlerësimit Atalanta Zeqiraj, në formularin e vetëvlerësimit ka deklaruar si vijon: Për vitin 2013, në periudhën e stazhit të kryer në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, i janë caktuar 82 çështje civile dhe 1(një) çështje penale masë sigurimi. Nga ky volum çështjesh të marra për gjykim gjuqtarja deklaroi se ka përfunduar së gjykuari 64 çështje civile, si dhe një çështje penale masë sigurimi. Për vitin 2014, në periudhën e stazhit të kryer në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, i janë caktuar 48 çështje civile 10 çështje penale masë sigurimi, si dhe 8 çështje penale themeli. Gjuqtarja deklaroi se i ka përfunduar së gjykuari të gjitha çështjet e marra për gjykim prej saj.

Sipas të dhënave statistikore të vëna në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr. *** prot., datë 13.9.2019, për efekt të shortit, gjuqtarja Atalanta Zeqiraj, i janë caktuar për gjykim 131 çështje civile e penale dhe ajo i ka përfunduar të gjitha së gjykuari. Si rezultat, rendimenti i gjuqtarja Atalanta Zeqiraj, në gjykimin e çështjeve si stazhiere në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë është 100%. Për vitin 2015, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, pas emërimit përfundimtar, gjuqtarja ka deklaruar se ka përfunduar 77 çështje, nga të cilat 57 çështje civile dhe 20 çështje penale. Nuk është deklaruar prej saj sa çështje ka marrë për gjykim në atë periudhë. Për vitin 2016, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, pas emërimit përfundimtar, gjuqtarja ka deklaruar se ka përfunduar 202 çështje, nga të cilat 175 çështje civile dhe 27 çështje penale. Gjuqtarja ka deklaruar se për vitin 2017, ka mbartur për gjykim 76 çështje. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna është 72.6%.

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën tetor 2013 – gusht 2014, gjuqtare Atalanta Zeqiraj, ka përfunduar së gjykuari 131 çështje. Nga ky total 32 janë çështje civile të përgjithshme+ familjare dhe 80 janë çështje civile të veçanta, 8 janë penale themeli dhe 11 janë çështje penale masa sigurimi. Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me shkresën nr. *** prot., datë 20.9.2019, për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën 25.9.2015 – 8.10.2016, gjuqtare Atalanta Zeqiraj, ka përfunduar së gjykuari 132 çështje. Nga ky total, 28 janë çështje civile të përgjithshme+ familjare dhe 85 janë çështje civile të veçanta, 3 janë penale themeli, 6 janë kërkesa penale dhe 20 janë çështje penale masa sigurimi.

Komisioni, në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Atalanta Zeqiraj, është “e aftë”, pasi ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe është efiçente në masë të pranueshme.

DENONCIME

Për subjektin e rivlerësimit janë paraqitur 6 denoncime si vijon:

1. Denoncim nr. *** prot., datë 20.3.2018, i shtetasit G.T. Ky denoncues ka denoncuar shumë subjekte rivlerësimi, ndër to, edhe subjektin Atalanta Zeqiraj. Nuk rezultojnë *indicie* nga ky denoncues për subjektin e rivlerësimit.
2. Denoncim nr. *** prot., datë 14.5.2018, i shtetasit E.O. Ky denoncues ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për shkelje ligjore, profesionale dhe lidhje politike. Nuk rezultojnë *indicie* lidhur me shkelje të subjektit të rivlerësimit.

3. Denoncim nr. *** prot., datë 7.6.2018, i shtetasit P.P. Ky denoncues ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për shkelje ligjore dhe vendim të padrejtë. Nuk rezultojnë *indicie* lidhur me shkelje të subjektit të rivlerësimit.

4. Denoncim nr. *** prot., datë 22.7.2019, i shtetasit A.R. Ky denoncues ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për shkelje ligjore. Bashkëlidhur ka paraqitur vendimin nr. ***, datë 10.6.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Subjekti me anë të këtij vendimi ka pranuar kërkesën e prokurorisë dhe ka deklaruar fajtor denoncuesin për veprën penale “vendime në kundërshtim me vendimin e gjykatës”. Nuk u konstatuan shkelje të subjektit lidhur me këtë vendim gjyqësor.

5. Ankesë nr. *** prot., datë 3.7.2018, e shtetases R.B. Kjo denoncuese ka denoncuar 3 subjekte rivlerësi, ndër to, edhe subjektin Atalanta Zeqiraj për shkelje të rënda procedurale. Për këtë çështje është kërkuar dosja pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

6. Denoncim nr. *** prot., datë 22.11.2019, i shtetasit I.A. Ky denoncues ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për vendim të padrejtë. Denoncuesi ka paraqitur vendimin nr. ***, datë 15.4.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në të cilin gjyqtare e vetme e kësaj çështjeje është subjekti i rivlerësimit. Për këtë çështje Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka kërkuar dënimin e denoncuesit për kryerjen e veprës penale “kundërshtim të punonjësit të policisë së rendit publik” kryer me dhunë dhe “veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës”. Në përfundim gjykata ka vendosur deklarinimin fajtor të denoncuesit për veprën penale “kundërshtim të punonjësit të policisë së rendit publik” dhe dënimin e tij me 1 vit burg.

Nuk u konstatuan shkelje të subjektit lidhur me këtë vendim gjyqësor.

Konstatime të tjera të Komisionit

Pas vlerësimit të informacionit që disponoi Komisioni, u kërkuar praktikat dhe vendimet e dhëna nga gjykata dhe subjekti për të cilat rezultuan *indicie*, lidhur me 4 çështje gjyqësore.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me shkresën nr. *** prot., datë 6.5.2021, si dhe gjykatat përkatëse kanë dërguar informacionin e kërkuar nga Komisioni lidhur me disa vendime gjyqësore. Nga praktika e dërguar rezulton se:

1. Me vendimin nr. ***, datë 19.7.2017, gjyqtari L.F, si gjyqtari vetëm, pas shqyrtimit të çështjes me objekt “prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit” dhe “kanosje”, të parashikuara nga neni 278/1 dhe 84 i Kodit Penal, ka vendosur: deklarinimin fajtor të pandehurit Sh.B për kryerjen e veprave penale të sipërcituara dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim dhe pas aplikimit të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale dënimin përfundimtar me 3 vjet e 4 muaj burgim.

Siç konstatohet subjekti i rivlerësimit Atalanta Zeqiraj nuk ka qenë gjyqtare e kësaj çështjeje.

2. Me vendimin nr. ***, datë 12.9.2018, subjekti i rivlerësimit Atalanta Zeqiraj, ka vendosur: deklarinimin fajtor të të pandehurve E.D dhe F.K, për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe shitje të narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tyre me nga 5 vjet burgim. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale zbritet 1/3 e dënimit. Detyrimin për zbatim të neneve 60 dhe 61 të Kodit Penal, si dhe në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal pezullimi i ekzekutimit me burgim për pjesën e mbetur dhe vënia në provë për secilin të pandehur për një 5 vite, me kusht që gjatë kësaj kohe i pandehuri të mos kryejë veprë tjetër penale dhe të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës.

Çështja është regjistruar sipas shortit elektronik në gjykatë në datën 23.5.2018, sipas kërkesës së ardhur nga prokuroria për dërgimin në gjyq të çështjes penale në ngarkim të të pandehurve

E.D dhe F.K akuzuar për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal.

Rezulton në dosje vendimi i caktimit të seancës së parë gjyqësore. Është respektuar afati 10-ditor dhe elementët e njoftimit të përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale.

Seanca gjyqësore e datës 14.6.2018 është çelur 14 minuta me vonesë dhe është dokumentuar me procesverbal dhe është regjistruar në audio. Në përmbajtje të procesverbalit të mbajtur në mënyrë të përmbledhur nuk dokumentohet shkaku i fillimit me vonesë të gjykimit. Shtyhet seanca gjyqësore me qëllim paraqitjen e prokurës së njërit prej dy avokatëve të pranishëm. Seanca tjetër caktohet në datën 29.6.2018, ora 09:00. Kjo seancë fillon me 16 minuta vonesë dhe shtyhet përsëri me kërkesë të avokatëve. Seanca tjetër caktohet në datën 9.7.2018, ora 09:00, e cila fillon me 8 minuta vonesë dhe palët konfirmojnë qëndrimin ndaj kërkesës për gjykim të shkurtuar. Seanca e radhës caktohet në datën 19.7.2018, ora 12:30, ku prokurori paraqet konkluzionet përfundimtare. Seanca tjetër caktohet në datën 23.7.2018, ora 13:00, e cila shtyhet me kërkesë të njërit prej dy avokatëve të të pandehurve. Seanca e radhës caktohet në datën 12.9.2018, ora 13:00, e cila fillon me 8 minuta me vonesë dhe pas paraqitjes së konkluzioneve përfundimtare të dy avokateve të të pandehurve, gjykata tërhiqet për vendim dhe shpall vendimin po atë ditë.

Vendimi është arsyetuar dhe dorëzuar nga gjyqtarja Atalanta Zeqiraj brenda afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 të Kodit të Procedurës Penale.

Gjykimi i çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka zgjatur 3 muaj dhe 11 ditë dhe kohëzgjatja e gjykimit nga kjo gjyqtare ka respektuar standardin e procesit të rregullt ligjor të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së.

Vendimi përfundimtar nr. ***, datë 12.9.2018, përmban pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe dispozitivin e gjykatës, në përputhje me kërkesat e nenit 383 të Kodit të Procedurës Penale.

Dispozitivi i vendimit është i qartë dhe i kuptueshëm. Ai është konkluzion i analizës së pjesës përshkruese-arsyetuese. Në vendim janë respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive, dhe përdoren rregullisht karakteret e gjuhës shqipe. Kundër vendimit nuk rezulton të jetë ushtruar ankimi.

Nuk rezultoi problematikë për këtë çështje gjyqësore që lidhet me subjektin e rivlerësimit.

3. Me vendimin nr. ***, datë 26.9.2019, subjekti i rivlerësimit Atalanta Zeqiraj, ka vendosur rrezimin e kërkesës si të pabazuar në prova e në ligj.

Me vendimin nr. ***, datë 19.7.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur: deklarinim fajtor të pandehurit Sh.B për kryerjen e veprave penale “prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit” dhe “kanosje”, të parashikuara nga neni 278/1 dhe 84 i Kodit Penal, dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim dhe pas aplikimit të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale dënimin përfundimtar me 3 vjet e 4 muaj burgim.

I pandehuri Sh.B ka kërkuar *ulje dënimi me 45 ditë*, në referim të nenit 63 të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim e të paraburgosurve”, i ndryshuar. Kërkesa është dorëzuar në datën 13.9.2019 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, sipas shortit elektronik të kësaj date, i ka rënë gjyqtarës Atalanta Zeqiraj Në dosjen gjyqësore evidentohet vendimi i caktimit të seancës gjyqësore në datën 26.9.2019, ora 11:15. Seanca gjyqësore është çelur 21 minuta me vonesë dhe gjyqtarja Atalanta Zeqiraj, pasi ka dëgjuar palët ka rrezuar kërkesën, duke arsyetuar se ajo është e pabazuar në ligj, për sa kohë nuk kanë kaluar 12 muaj nga marrja e vendimit me të cilin është bërë ulja e mëparshme e

dënimin (vendimi nr. ***, datë 1.3.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan). Në faqen 3 të vendimit konstatohet se, fjalia e fundit e pjesës arsyetuese - *sa më sipër, gjykata vlerëson se duhet të pranohet kërkesa e të dënuarit Sh.B si e bazuar në ligj e prova* - mund të jetë shkruar gabim.

Vendimi përfundimtar nr. ***, datë 26.9.2019, përmban pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe dispozitivin e gjykatës, në përputhje me kërkesat e nenit 383 të Kodit të Procedurës Penale.

Dispozitivi i vendimit është i qartë dhe i kuptueshëm. Ai është konkluzion i analizës së pjesës përshkruese - arsyetuese. Në vendim janë respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive, dhe përdoren rregullisht karakteret e gjuhës shqipe. Kundër vendimit nuk rezulton të jetë ushtruar ankim.

Nuk rezultoi problematikë për këtë çështje gjyqësore që lidhet me subjektin e rivlerësimit.

4. Ankesa nr. *** prot., datë 3.7.2018, e shtetases R.B. Kjo denoncuese ka denoncuar dy subjekte rivlerësimi, ndër to, edhe subjektin Atalanta Zeqiraj për shkelje të rënda procedurale. Për këtë çështje është kërkuar dosja pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe me shkresën kthim përgjigje, nr. *** prot., datë 17.5.2021, kjo gjykatë na vë në dispozicion praktikën e kësaj çështjeje deri tani.

Ankuesja ka paraqitur ankesë, ku kërkon verifikimin e shkeljeve të rënda të gjyqtarëve, ndër to, edhe për gjyqtaren Atalanta Zeqiraj, pjesë e trupës gjyqësore e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, ku subjekti ka qenë anëtare në dhënien e vendimit të datës 21.6.2018 për deklarimin fajtor të S.Xh, për kryerjen e veprës penale “vrasje me paramendim”, e parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal etj.

Rrethanat e çështjes: në datën 1.6.2017, shtetasi S.Xh qëllon për vdekje E.B (bashkëshorti i ankuseses), pas kryerjes së krimit, ai shkon në shtëpinë e tij dhe pas pak minutash, telefonon Inspektorin e Policisë së Zonës dhe vetëdorëzohet. Ai ka treguar ngjarjen me detaje, ku pohon faktin ta ketë vrarë viktimën me armë zjarri, për shkak të dyshimeve të mëparshme që e kanë dëmtuar dhe i kanë shkaktuar shqetësime psikike, por jo të ketë pasur mendim më parë për ta vrarë. Mendimi për ta vrarë i ka ardhur në moment. Këto janë pjesë nga deklaratimet e tij përpara prokurorit të çështjes.

Familjarët e viktimës kanë kërkuar tre herë përjashtimin e trupit gjykues dhe vetëm kur ata kanë paraqitur kallëzim penal për dy prej tyre përpara prokurorisë, atëherë gjykata i ka zëvendësuar ata me dy gjyqtare të deleguara nga Vlora: Atalanta Zeqiraj dhe A.S. Ndërkohë gjyqtari i tretë, z. S.P, vazhdoi përsëri të ishte pjesë e trupës gjyqësore duke qenë se ai kishte dalë me mendim pakicë ndaj kërkesës së pranuar për gjykim të shkurtuar nga i pandehuri S.Xh.

Në datën 21.6.2018, është zhvilluar seanca gjyqësore. Në këtë seancë familjarët e viktimës dhe avokati i tyre kanë kërkuar marrjen e provave të reja dhe gjykata nuk e ka pranuar këtë kërkesë, por ka zhvilluar gjykimin dhe ka shpallur vendimin në një hark kohor prej 105 minutash. Pretendohet nga ankuesja se dy gjyqtaret nga Saranda nuk ishin njohur me dosjen penale, e cila përbëhet nga 424 faqe, meqenëse atë ditë kishin ardhur nga Vlora në Sarandë dhe dosja kishte qenë gjithnjë në Sarandë.

Pretendohet se gjykata nuk duhej të pranonte kërkesën për gjykim të shkurtuar dhe nëse më përpara trupa e mëparshme gjyqësore e kishte pranuar, tanimë dy prej tyre ishin zëvendësuar dhe çështja kishte filluar nga e para dhe, për pasojë, çdo kërkesë procedurale duhej të rikonsiderohej nga e para.

Në kushtet kur gjykata ka pranuar kërkesën për gjykim të shkurtuar të të pandehurit, i cili ka shkaktuar një krim të rëndë, siç është ai i vrasjes së familjarit të tyre E.B, ku familjet e tyre kishin edhe shumë miqësi së bashku, kjo e bën situatën më të rëndë duke shkuar deri aty sa ankuesja shprehet se *aty ku nuk ka drejtësi, ka vetëgjyqësi*.

Ankuesja përfundimisht duke iu drejtuar z. Ilir Meta, si Drejtues i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për dijeni, ankohet ndaj gjyqtare *Atalanta Zeqiraj për shkelje të solemnitetit të gjykimit, cenimit të rëndë të procesit të rregullt ligjor, cenimit të rëndë të figurës së gjyqtarit dhe besimit të publikut te figura e gjyqtarit, njëanshmërisë në gjykim, shkelje të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, pa u shprehur në lidhje me kërkesat e viktimës, pa arsyetuar vendimet e ndërmjetme as me gojë as me shkrim, ka dhënë një vendim pa lexuar dosjen gjyqësore dhe për të gjitha arsyet e sipërcituara, në një kohë gjyqtari S.P ka dalë me pakicë për mospranim të gjykimit të shkurtuar pra si këto gjyqtarë vendosen apriori, në një kohë që edhe prokurori ishte kundër gjykimit të shkurtuar?*

Komisioni me qëllim hetimin administrativ të kësaj ankese i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, ku i kërkon kopje të praktikës gjyqësore dhe vendimin/et gjyqësore për procedimin penal nr. *** në ngarkim të S.Xh.

Në përgjigje kjo gjykatë, ka dërguar shkresën kthim përgjigje, ku na vënë në dispozicion kopje të vendimit gjyqësor nr. ***, datë 21.6.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe vendimin nr. ***, datë 30.10.2018, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, i cili ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, si dhe sqarojnë se dosja që u përket këtyre vendimeve ndodhet për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Nga studimi i vendimeve Komisioni vëren se: I pandehuri S.Xh ka vrarë me armë të ndjerin E.B dhe e ka pranuar se ka kryer vrasjen. Pas kryerjes së krimit S.Xh ka shkuar në shtëpinë e tij dhe ka njoftuar Inspektorin e Policisë së Zonës dhe është vetëdorëzuar. Autori i krimit ka dëshmuar dinamikën e kryerjes së krimit dhe Policia Gjyqësore dhe prokuroria kanë kryer hetimet e nevojshme duke realizuar kryerjen e aktespertimeve: daktiloskopik; tekniko-balistik; mjeko-ligjor; kimik; procesverbalet e këqyrjes së vendit të ngjarjes; procesverbalet e këqyrjes dhe marrjes së dokumenteve e deklarimeve të shtetasve dhe më pas prokurori i është drejtuar gjykatës me akuzën e kryerjes së veprës penale “vrasje me paramendim” dhe “prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve të gjuetisë dhe sportive”, të parashikuara nga nenet 78/1 dhe 280 i Kodit Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe Gjykata e Apelit Gjirokastrë kanë mbajtur të dyja një qëndrim në lidhje me procedimin e gjykimit duke iu referuar një prej formave të gjykimit të posaçëm, atij me gjykim të shkurtuar, për sa kohë vepra penale rezulton totalisht e provuar me provat, faktet e deklarimet e personit që ka kryer veprën penale. Në këto kushte, sipas fashikullit hetimor që në këtë rast është kthyer në fashikull gjyqësor në këndvështrim të vendimit unifikues nr. 2, datë 29.1.2003, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet.

Kështu në fund të gjykimit të çështjes me vendimin gjyqësor nr. ***, datë 21.6.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka vendosur:

Deklarimin fajtor të të pandehurit S.Xh për kryerjen e veprës penale “vrasje me paramendim”, e parashikuar nga paragrafi i parë i nenit 78 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 25 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit S.Xh për kryerjen e veprës penale “prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive”, e parashikuar nga neni 280 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2 vjet burgim.

Në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve, dënimi përfundimtar për të dy veprat do jetë 27 vjet burgim.

Në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimi i dhënë për të pandehurin S.Xh ulet me një të tretën dhe përfundimisht i pandehuri dënohet me 18 vjet burgim.

Bazuar në nenin 65/a të Kodit Penal, vendoset periudha e sigurisë gjatë së cilës nuk lejohet zbatimi i nenit 64 të këtij kodi. Periudha e sigurisë shtrihet për gjithë kohën e dënimit të caktuar.

Me vendimin nr. ***, datë 30.10.2018, Gjykata e Apelit Gjirokastrë ka lënë në fuqi vendimin nr. ***, datë 21.6.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Çështja ndodhet e shortuar për gjykim në Gjykatë të Lartë.

Ankuesja R.B ankohet se gjykata dhe pikërisht gjyqtaret Atalanta Zeqiraj dhe A.S, pjesë të trupës gjyqësore prej tre anëtarëve, kanë pranuar kërkesën për gjykim të shkurtuar dhe kanë gjykuar çështjen me këtë lloj gjykimi. Edhe avokati i tyre e ka kundërshtuar pranimin e kësaj kërkesë nga trupa gjyqësore, duke shkuar edhe më tej, duke kërkuar marrjen e provave të reja në një fazë gjykimi, kur nga gjykata është konsideruar e pamundur për shkak se çështja konsiderohej e hetuar plotësisht.

Pika 2, e nenit 403, kërkesa për gjykimin e shkurtuar, të Kodit të Procedurës Penale, i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, përcakton se *nuk lejohet kërkesa për gjykim të shkurtuar për veprat penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm.*

Ndodhur në kushtet kur si prokurori ashtu edhe gjykata kanë bërë të njëjtin cilësim juridik të veprës penale atë të “vrasjes me paramendim”, parashikuar nga paragrafi i parë i nenit 78 të Kodit Penal, i cili parashikon se: *“Vrasja me paramendim dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë gjer në njëzet e pesë vjet”*, nuk jemi para faktit të moslejimit të bërjes së kësaj kërkesë dhe aq më pak të mospranimit të saj në këndvështrim të kualifikimit të veprës penale sipas nenit 78/1 të Kodit Penal.

Në përfundim, për sa i përket kësaj çështje, nuk vihet re të ekzistojnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit.

Komisioni arrin në përfundimin se në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, këto denoncime nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova që ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

V. VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vlerësimit të figurës dhe vlerësimit profesional, si dhe në vlerësimin tërësor të procedurave, Komisioni, arrin në përfundimin se:

Për vlerësimin e pasurisë

Trupi gjykues, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, kreut IV dhe nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, bindjen e brendshme, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, konkludon se subjekti i rivlerësimit Atalanta Zeqiraj *ka kryer deklarin të mjaftueshëm dhe në vlerësim tërësor të saktë të pasurisë, duke konstatuar pasaktësi të karakterit minimal.*

Nga analiza e bërë nga Komisioni u konstatuan disa problematika, të cilat vijnë si rezultat i veprimeve të kryera nga babai i subjektit, si dhe mosveprimi në kohë i subjektit për të shmangur konfliktin e interesit në dukje. Por këto veprime dhe mosveprime të subjektit nuk mund të çojnë në konkluzionin se ndodhemi përpara një deklarimi të pamjaftueshëm dhe, për rrjedhojë, në aplikimin e masës disiplinore referuar nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit subjekti ka kryer deklarim të saktë të pasurive dhe interesave private, si edhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj në pronësi dhe përdorim. Subjekti nuk është përpjekur të fshehë dhe të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi apo përdorim.

Në rastin e subjektit të rivlerësimit Atalanta Zeqiraj, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, nuk vërtetohen shkaqet që neni D i Kushtetutës, i ka parashikuar të tilla që zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit. Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit justifikon plotësisht me burime të ligjshme krijimin e pasurive (gjendjet e likuiditeteve në llogari bankare dhe në *cash*), si dhe kryerjen shpenzimeve përgjatë gjithë periudhës që ka ushtruar funksionin si gjyqtar.

Për vlerësimin e figurës

Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta.

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Atalanta Zeqiraj, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

Për vlerësimin e aftësive profesionale

Në përfundim, lidhur me kriterin profesional, trupi gjykues, pas vlerësimit të parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti dhe propozimit të relatorit të çështjes arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues, në kuptim të germës “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUSIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti i rivlerësimit Atalanta Zeqiraj ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “a”, pika 1, të nenit 58, si dhe të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Atalanta Zeqiraj, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë në datën 30.6.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Firdes SHULI
Kryesuese

Roland ILIA
Relator

Etleda ÇIFTJA
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Ertugena Sokoli/ Amela Idrizi